



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.10

2004

5 mars

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9176
datë 29.1.2004

Për ratifikimin e "Marrëveshjes, ndërmjet Ministrisë së
Financave, që vepron në emër të shtetit shqiptar, Korporatës
Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Bankës Europiane për
Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për blerjen e aksioneve të
INSIG sha-së" 405

Ligj nr.9177
datë 29.1.2004

Për ratifikimin e "Marrëveshjes së aksionarëve, ndërmjet
Ministrisë së Financave, që vepron në emër të shtetit
shqiptar, INSIG sha-së, Korporatës Financiare Ndërkombëtare
(IFC) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
(BERZH)" 433

L I G J
Nr.9176, datë 29.1.2004

**PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE,
QË VEPRON NË EMËR TË SHTETIT SHQIPTAR, KORPORATËS FINANCIARE
NDËRKOMBËTARE (IFC) DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM (BERZH), PËR BLERJEN E AKSIONEVE TË INSIG SHA-SË"**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja, ndërmjet Ministrisë së Financave, që vepron në emër të shtetit shqiptar, Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për blerjen e aksioneve të INSIG Sha-së".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4135, datë 20.2.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE

**PËR BLERJE AKSIONESH NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE SI PRONARE E
AKSIONEVE TË INSIG SHA-së, QË VEPRON NË EMËR TË SHTETIT SHQIPTAR,
BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM DHE KORPORATËS
FINANCIARE NDËRKOMBËTARE**

Marrëveshje e datës _____ shtator 2003, ndërmjet Ministrisë së Financave si pronare e aksioneve të INSIG-ut, që vepron në emër të shtetit shqiptar në bazë të ligjit nr.8831, datë 22 nëntor 2001 mbi pronësinë shtetërore të shoqërive tregtare financiare me kapital aksionar shtetëror të plotë, i përfaqësuar nga Ministri i Financave (Shitësi), Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC),

ku:

A. Instituti i Sigurimeve sh.a. është një shoqëri anonime e organizuar, ekzistuese dhe e licencuar si shoqëri sigurimesh, në zbatim të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë (Shoqëria).

B. Kapitali i autorizuar ekzistues aksionar i Shoqërisë konsiston në 1700 000 000 lekë, i ndarë në 1700 aksione të përbashkëta me të drejtë vote me vlerë 1 000 000 secila, të cilat të gjitha janë lëshuar në emër dhe pronësi të Shitësit (Aksione ekzistuese).

C. Në përputhje me legjislacionin mbi privatizimin, Shitësi synon të privatizojë Shoqërinë.

D. Për të privatizuar Shoqërinë dhe në përputhje me legjislacionin mbi privatizimin dhe vendimet e Këshillit të Ministrave, Shitësi dëshiron të shesë tridhjetë e nëntë për qind (39%) të aksioneve ekzistuese, prej të cilave treqind e tridhjetë e dy (332) aksione do të blihen nga EBRD (Aksionet EBRD) dhe treqind e tridhjetë e dy (332) do të blihen nga IFC (Aksionet IFC) në zbatim të kushteve dhe rrethanave të kësaj Marrëveshjeje,

prandaj, palët bien dakord si vijon:

KREU I PËRKUFIZIME

Neni 1.01 Përkufizime

Termat e mëposhtëm, kur nga konteksti nuk del ndryshe, kanë kuptimin e mëposhtëm kudo që përdoren në këtë Marrëveshje (duke përfshirë tabelat dhe shtojcat):

“Vlera kontabël për aksion” është 1 607 612 (një milion e gjashtëqind e shtatë mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë), që përfaqëson vlerën neto të aktiveve të Shoqërisë pjesëtuar me numrin e aksioneve ekzistuese.

“Vlera e korrigjuar për aksion” përkufizohet në nenin 3.05 (b)(i).

“Shteti shqiptar” është Republika e Shqipërisë.

“Ligji i zbatueshëm” është çdo akt kombëtar apo vendor, vendim, urdhër, dekret ose akt tjetër i së drejtës, rregullore, urdhëresë ose rregull, kod, udhëzim ose çdo licencë, dhënie pëlqimi, leje, autorizim apo miratim tjetër duke përfshirë çdo kusht bashkëlidhur (në lidhje me mjedisin ose tjetër) i Republikës së Shqipërisë apo një pjese të saj, subjekti shtetëror ose personi juridik (i pavarur ose jo) që ka juridiksion të zbatueshëm.

“Ekspert kontabël” është çdo zyrë kontabilistësh të pavarur, të cilët Shoqëria kohë pas kohe mund t’i emërojë si ekspertët e saj kontabël, në përputhje me nenin 4.01 dhe Marrëveshjen e aksionarëve.

“Autorizim” është dhënie pëlqimi, lejim, licencim, dhënie koncesioni, refuzim, autorizim, miratim apo dhënie certifikate në lidhje me EBRD-në ose IFC-në dhe Shitësin, lëshimi apo rinovimi i së cilës është në kompetencë të bursës apo ndonjë subjekti shtetëror, që kërkohet nga Shoqëria apo ndonjë nga Palët për zbatim të projektit apo e lidhur me ndonjë nga aktivitetet e tyre në Republikën e Shqipërisë të parashikuara në këtë Marrëveshje apo ndonjë tjetër dokument të projektit përfshirë licencat e sigurimit.

“Ditë-pune” është çdo ditë (përveç të shtunës e të dielës), gjatë së cilës bankat tregtare dhe tregjet e huaja të këmbimit janë të hapura për transaksione tregtare në tregun ndërbankar të dollarit në Tiranë, Shqipëri, Londër, Angli, Nju Jork, SHBA.

“Ndryshim në ligj” është nxjerrja, kalimi, hyrja në fuqi, revokimi, rrëzimi, amendimi apo abrogimi i ndonjë ligji në zbatim ose autorizim, i cili bëhet efektiv pas datës së kësaj Marrëveshjeje ose çdo ndryshim tjetër në interpretim ose zbatim të sipërpërmendurave nga ndonjë subjekt shtetëror.

“Statut” do të thotë dokumentet e themelimit të Shoqërisë, duke përfshirë aktin e themelimit, procesverbalin e takimit themelues, urdhrin e regjistrimit nr.21463 lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë më 8 qershor 1999 për krijimin e Shoqërisë dhe statuti i regjistruar sipas këtij urdhri (në përputhje me ligjin e zbatueshëm).

“Datë maturimi” është:

i) Përsa i përket interesit që rrjedh nga një shumë e vonuar:

a) data e pagesës së kësaj shume;

b) datat që bie, gjashtë muaj pas datës së pagesës;

c) çdo përvjetor i datave të përcaktuara në fjalitë (a) dhe (b) më sipër.

ii) Përsa i përket shumës së korrigjimit të çmimit:

a) data e transferimit;

b) data që bie gjashtë muaj pas kësaj date;

c) çdo përvjetor i datave të përcaktuara në fjalitë (a) dhe (b) më sipër,

duke parashikuar që nëse kjo datë nuk është ditë-pune, atëherë data e maturimit do të jetë dita e ardhshme e punës.

“Periudhë maturimi” është çdo periudhë 6-mujore, që fillon nga data e maturimit dhe përfundon në ditën që ndjek datën e ardhshme të maturimit pa e përfshirë atë, përveç periudhës së fundit të maturimit, që përfundon në ditën e pagesës pa e përfshirë atë (për efekt të çdo llogaritjeje sipas nenit 7.06 ose 3.05 (b)).

“Shoqëri” përkufizohet në përshkrimin A.

“Letër informacioni e shoqërisë” është letra që i dërgon Shoqëria e EBRD-së apo IFC-së në datë () 2003, e cila përmban deklaratimet e Shoqërisë në lidhje me fakte të rëndësishme për projektin, organizimin, statusin, aktivitetet, lidhjet, aktivet dhe detyrimet e shoqërisë apo çështje të tjera rastësore të transaksioneve të parashikuara nga kjo Marrëveshje dhe dokumentet e tjera të projektit (të konfirmuara me shkrim nga kjo Marrëveshje apo përpara datës së saj).

“Vendimet e Këshillit të Ministrave” është (të futen detaje identifikuese në vendimet përkatëse).

“Dollarë” dhe “US \$” është monedha shtetërore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

“Aksione EBRD” përkufizohen në përshkrimin D.

“Udhëzime mjedisore” janë politikat mjedisore dhe sociale të blerësve të zbatueshme në operacionet e shoqërive të sigurimeve.

“Aksionet ekzistuese” përkufizohen në përshkrimin B.

“Rasti i korrigjimit të çmimit të situatës financiare” përkufizohet në nenin 3.05 (a).

“Deklaratat financiare” do të thotë deklaratat financiare të audituara ose jo (duke përfshirë bilancin, deklarin e të ardhurave, deklarin e qarkullimit të parave *cash* dhe shënimet mbi to), të Shoqërisë të përgatitura në përputhje me IAS.

“Vit financiar” do të thotë viti financiar i Shoqërisë, aktualisht periudha që fillon çdo vit më 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetorin vijues.

“Kredi shtëpie” është kredia që u jep Shoqëria personave me qëllim ndërtimin e shtëpive për punonjësit e Shoqërisë.

“IAS” janë standardet financiare ndërkombëtare të kontabilitetit të shpallura ose të miratuara nga Këshilli Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit dhe të zbatuara me korrektësi.

“Aksione IFC” përkufizohen në përshkrimin D.

“Çmimi fillestar i blerjes” është çmimi për t’u paguar nga çdo blerës në përputhje me nenin 3.02 në vlerë 624 000 000 (gjashtëqind e njëzet e katër milionë), si vlerë treguese e çdo aksioni e shumëzuar me numrin e aksioneve të shitjes dhe me 1.17.

“E drejta e sigurimeve” është ligji i Republikës së Shqipërisë nr.8081, datë 7 mars 1996 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”, i ndryshuar dhe zëvendësuar, si dhe çdo ligj tjetër mbi aktivitetin e sigurimeve.

“Licencë sigurimesh” është licenca nr.3, në lidhje me sigurimet e jo jetës, si dhe licenca nr.4 në lidhje me sigurimet e jetës, të dyja këto të lëshuara më 8 qershor 2000 nga rregullatori i sigurimeve.

“Rregullator sigurimesh” është Komisioni Mbikëqyrës i Sigurimeve i organizuar dhe që ekziston sipas ligjit të zbatueshëm.

“Normë ndërbankare” është norma vjetore e ofruar për depozitat në dollarë për çdo periudhë maturimi, e cila paraqitet në faqen e referencës si e orës 11.00, koha e Londrës, në ditën dy ditë-pune para ditës së parë të kësaj periudhe maturimi. Për periudhën që është më pranë kohëzgjatjes së kësaj periudhe maturimi (ose nëse dy periudha janë njësoj pranë kohëzgjatjes së kësaj periudhe maturimi, mesatarja e dy normave përkatëse), duke parashikuar që:

a) nëse, për ndonjë arsye, norma ndërbankare nuk mund të përcaktohet në këtë kohë duke iu referuar faqes së referencës. Norma ndërbankare për këtë periudhë maturimi do të jetë norma vjetore, e cila është kuptimi aritmetik (afërsisht 1/16 e një përqindëshi e rrumbullakosur nga sipër, nëse është e nevojshme) i normave vjetore të ofruara për depozitat në dollarë në shumë të krahasueshme me shumën e papaguar për një periudhë të njëjtë me periudhën e maturimit, të sugjeruara këto blerësve nga tri bankat aktive më të mëdha në tregun ndërbankar të Londrës, të zgjedhura nga Blerësit dhe

b) nëse ndonjë palë përcakton se depozitat në dollarë nuk janë ofruar në tregun ndërbankar të Londrës në shumën të tilla apo për periudha të tilla. Norma ndërbankare për këtë periudhë maturimi do të jetë kostoja e të paguarit të shumës së vonuar (e shprehur si normë vjetore) të financimit të pjesës së shumës së vonuar që është krijuar gjatë periudhës së maturimit, e zgjedhur nga çfarëdo burim.

“Lekë” është monedha shtetërore e Republikës së Shqipërisë.

“Barrë” është çdo hipotekë, peng, tatim, privilegj, përparësi, barrë, detyrim, sigurim padie, kompensim ose ndonjë interes tjetër sigurimi të çdo lloji apo ndonjë lloj tjetër marrëveshjeje apo ujdje me efekt apo që jep siguri mbi apo ndaj ndonjë aktivi, të ardhure, të drejte ekzistuese apo të ardhshme, duke përfshirë pa kufizim çdo humbje titulli si i pagueshëm apo përfitues apo të ngjashme me këto sipas ndonjë politike sigurimi.

“Ministër i Financave” është Ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë.

“Ministër i Drejtësisë” është Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë.

“Ministria e Financave”: Ministria e Financave e përfaqësuar nga Ministri, vepron në emër të shtetit dhe është pronare e bankave tregtare dhe e shoqërive shtetërore të sigurimit të dëmeve dhe të jetës, të cilat janë me kapital tërësisht shtetëror.

“Vlerë neto e aktiveve” është vlera e të gjitha aktiveve të Shoqërisë, duke zbritur të gjitha detyrimet e Shoqërisë, të përcaktuara në deklaratën financiare të 31 dhjetorit 2002 të certifikuar nga ekspertët kontabël.

“Deklaratë e politikës operative” është deklarata e politikës operative në lidhje me biznesin dhe operacionet e shoqërisë bashkëlidhur këtu si shtojca A.

“Kuvend” do të thotë Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

“Palë” do të thotë palë e kësaj Marrëveshjeje.

“Shumë e korigjimit të çmimit” përkufizohet në nenin 3.05(a).

“Normë e interesit të korigjimit të çmimit” është norma ndërbankare (për çdo periudhë përkatëse maturimi) nga data e transferimit, interes i llogaritur në bazë të numrit të kaluar nga viti 360 ditësh dhe maturuar në fund të çdo periudhe maturimi.

“Ligje të privatizimit” është ligji i Republikës së Shqipërisë nr.8898 i datës 22 maj 2002

“Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të INSIG sh.a.”, si dhe çdo ligj apo vendim Kuvendi që i drejtohet privatizimit të Shoqërisë apo shprehimisht miraton këtë Marrëveshje dhe çdo dokument tjetër të projektit.

“Projekt” është privatizimi me dy faza i Shoqërisë në përputhje me ligjet e privatizimit si vijon:

a) Faza I: shitja e aksioneve EBRD-EBRD-së dhe shitja e aksioneve IFC-IFC-së;

b) Faza II: shitja, në përputhje me ligjin e privatizimit, të paktën pesëdhjetë e një për qind (51%) të aksioneve ekzistuese një investitori strategjik brenda një periudhe jo më larg se njëzet e katër (24) muaj nga data e kësaj Marrëveshjeje.

“Dokumentet e projektit” është marrëveshja, statuti, letra e informacionit të Shoqërisë, kontrata e aksionarëve dhe marrëveshja e rishitjes.

“Blerës” është EBRD dhe IFC apo përfaqësuesit e lejuar përkatës të tyre.

“Marrëveshja e rishitjes” është marrëveshja e rishitjes e së njëjtës datë bashkëlidhur kësaj, ndërmjet Shitësit, EBRD-së dhe IFC-së.

“Faqe e referencës” është shfaqja e normave të ofruara ndërbankare londineze të bankave më të mëdha për depozitat në dollarë paraqitur si faqja 3750 në Teleratë Service (ose ndonjë faqe tjetër që mund të zëvendësojë faqen 3750 për qëllim të shfaqjes së normave interbankare londineze të ofruara për depozitat në dollarë).

“Kërkesë për pagesë” përkufizohet në paragrafin 3.03 (a)

“Shitja e aksioneve” janë aksionet EBRD dhe IFC

“Aksion” janë aksionet e përbashkëta me të drejtë vote të emetuara dhe të shpallura të shoqërisë, së bashku me çdo të drejtë për të siguruar këto aksione, që do të përfshijë çdo të drejtë apo aksion të emetuar në shkëmbim, ndarje apo bashkim të këtyre aksioneve apo ushtrim i kësaj të drejte.

“Qendra e regjistrimit të aksioneve” është Qendra e Regjistrimit të Aksioneve e krijuar sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë nr.8108, datë 28 mars 1996 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nr.112, datë 19 shkurt 1996.

“Marrëveshje e aksionarëve” është Marrëveshja e aksionarëve e së njëjtës datë bashkëlidhur kësaj, ndërmjet shitësit, EBRD-së, IFC-së dhe Shoqërisë.

“Subjekt shtetëror” është:

a) vetë Republika e Shqipërisë;

b) Banka e Shqipërisë;

c) çdo trup legjislativ, organ i këmbimit të letrave me vlerë, ministri ose departament, organ gjyqësor, civil ose ushtarak i çdo lloji natyre (duke përfshirë çdo gjykatë) të Republikës së Shqipërisë apo çdo nënndarje politike apo administrative e Republikës së Shqipërisë;

d) çdo organ i qeverisjes vendore, korporatë, organizatë publike, ent tjetër në pronësi ose i kontrolluar drejtpërdrejt apo tërthorazi, që vepron për llogari apo në dobi të një apo disa agjencive të Republikës së Shqipërisë.

“Investitor strategjik” ka kuptimin që i atribuohet në ligjin e Republikës së Shqipërisë nr.8898 të datës 22 maj 2002 “Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të INSIG sh.a.

“Rasti i korrigjimit të çmimit të investitorit strategjik” përkufizohet në nenin 3.05(a).

“Filial” do të thotë kundrejt çdo subjekti, një subjekt tjetër, 50% të kapitalit aksionar të të cilit zotërohet, drejtpërdrejt apo tërthorazi, nga ky subjekt apo i cili është efektivisht i kontrolluar në mënyrë tjetër nga ky subjekt.

“Këshilli mbikëqyrës” do të thotë organi që ka përgjegjësi për drejtimin, strategjinë dhe politikat e Shoqërisë.

“Transferimi” do të thotë data transferimi dhe shitja e aksioneve EBRD dhe IFC nga Shitësi të secili prej EBRD dhe IFC në përputhje me nenin 3.01, 302 dhe 3.03.

“Data e transferimit” do të thotë data në të cilën kryhet transferimi, e cila pritët në datën e specifikuar nga Shitësi në kërkesën për disbursim dhe nënshkrim në të cilën ka për të ndodhur transferimi apo një datë tjetër për të cilën palët do të bien dakord.

“Garanci” janë deklaratimet dhe garancitë e bëra nga Shitësi në këtë Marrëveshje.

Neni 1.02

Interpretimi

a) Në këtë Marrëveshje, nëse nuk del ndryshe nga konteksti, fjalët e shënuara në njëjës përfshijnë shumësin dhe anasjelltas.

b) Në këtë Marrëveshje, nëse nuk shprehet qëllim i kundërt, referenca tek:

i) "aktive" përfshin prona, të ardhura dhe të drjeta të çdo lloji;

ii) "kontroll" (duke përfshirë, me kuptimet përkatëse, termat “kontrolluar nga”, “nën kontroll të përbashkët me”) kur përdoret ndaj një personi, do të thotë zotërim, drejtpërdrejt ose tërthorazi i tagrit për të drejtuar apo sjellë drejtimin e menaxhimit dhe politikave të këtij personi, nëpërmjet pronësisë së aksioneve me të drejtë vote, interesit pronësor, kontratave apo me mënyrë tjetër;

iii) "muaj" është referencë e një periudhe që fillon në një ditë të muajit kalendarik dhe mbaron në ditën korresponduese numerikisht të muajit tjetër kalendarik, përveç kur nuk ka ditë korresponduese numerikisht në muajin në të cilin kjo periudhë përfundon, rast në të cilin periudha përfundon në ditën e fundit të këtij muaji kalendarik;

iv) "person" përfshin çdo individ, person juridik, firmë, shoqëri, partneritet, subjekt shtetëror, shoqëri e përbashkët, bashkë me trashëgimtarët, përfituesit e lejuar apo ata të cilëve u ka transferuar ky person;

v) "rregullore" përfshin çdo udhëzim të ndonjë subjekti shtetëror;

vi) kjo Marrëveshje ose çdo dokument tjetër, kontratë ose marrëveshje do të përfshijë referencë të secilit variant i lejuar ose shtesë e kësaj Marrëveshjeje dhe këtij dokumenti, kontratë apo marrëveshje të ndryshuar, në variante, apo të shtuar kohë pas kohe, por pa përfshirë amendamente, shtesa, zëvendësime apo risi të bëra në kundërshtim me këtë Marrëveshje;

vii) "Marrëveshje" referimi në këtë Marrëveshje përfshin Marrëveshjen së bashku me përshkrimet dhe shtojcat e kësaj Marrëveshjeje;

viii) çdo ligj, akt, dekret ose dispozitë ligjore do të përfshijë (ruajë përsa i përket përcaktimit nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim i së drejtës) çdo ligj, akt, dekret ose dispozitë që ndryshon, zëvendëson apo ka ndryshuar, zëvendësuar atë dhe do të përfshijë çdo akt nënligjor (duke përfshirë

pa kufizim çdo udhëzim ose vendim të ndonjë subjekti shtetëror) në zbatim të këtij ligji, akti, dekreti ose dispozitë ligjore;

ix) përshkrim i caktuar, kre, nen ose shtojcë do të kuptohet referencë te ky nënshkrim i caktuar, kre, nen ose shtojcë e kësaj Marrëveshjeje;

x) titujt dhe përmbajtja janë vendosur vetëm për lehtësi referimi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje;

xi) një dokument në "formë të pranuar" do të thotë forma e këtij dokumenti e pranuar më parë nga palët;

xii) "përsa ka dijeni Shitësi" do të thotë që Shitësi ka bërë një hetim të kujdesshëm të Shoqërisë në lidhje me çështjen në fjalë dhe nuk ka marrë asnjë informacion të papajtueshëm me garancitë përkatëse.

KREU II DEKLARIMET DHE GARANCITË

Neni 2.01

Deklarime për privatizimin

Shitësi garanton çdo blerës që privatizimi i Shoqërisë është kryer dhe do të kryhet në përputhje me ligjet për privatizimin, vendimet e Këshillit të Ministrave dhe bie dakord që në vijim të datës së transferimit, Shitësi do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ose të përshtatshme për zbatimin e fazës së II-të të projektit.

Neni 2.02

Deklarime për Shoqërinë

Shitësi garanton çdo blerës se:

a) Shoqëria është një shoqëri anonime e organizuar rregullisht dhe vlefshmërisht në ekzistencë sipas ligjit të zbatueshëm, e regjistruar në të gjitha organet e duhura të regjistrimit në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria ka tagër të plotë të përdorë apo ketë në pronësi pronat që përdor apo ka në pronësi dhe ka tagër të plotë të kryejë biznesin dhe operacionet e saj.

b) Në datën e kësaj Marrëveshjeje, Shoqëria ka kapital aksionar të autorizuar prej 1 700 000 000 lekë të ndarë në 1700 aksione të thjeshta me vlerë nominale 1 000 000 lekë secila që formojnë aksionet ekzistuese.

c) Shitësi ka titull të plotë pronësie dhe zotëron të gjitha interesat përfituese të aksioneve ekzistuese. Të gjitha aksionet ekzistuese janë emetuar, shpallur dhe paguar plotësisht dhe përbëjnë të gjithë kapitalin e shpallur të nënshkruar dhe paguar plotësisht të Shoqërisë. Nuk ka kapar, dorëzani, instrumente të konvertueshme në aksione apo marrëveshje të tjera në lidhje me aksionet ekzistuese (veç atyre në zbatim të dokumenteve të projektit) apo për emetimin e aksioneve të tjera të çdo klase apo lloji. Përveç kur letra e informacionit shprehet ndryshe, asnjë person nuk ka ndonjë të drejtë (të ndryshme nga ato si aksionar) të marrë pjesë në fitimet e Shoqërisë (të ndryshëm nga agjentët e sigurimeve të cilëve u paguhet komisioni i brokerimit) apo të ketë ndonjë interes në aktivet e Shoqërisë. Nuk ka letra të tjera me vlerë të Shoqërisë drejtpërdrejt apo tërthorazi të konvertueshme apo të këmbyeshme me aksione.

d) Aksionet EBRD dhe ato IFC do të jenë të autorizuara rregullisht, vlefshmërisht të emetuara, të paguara dhe të lira plotësisht nga çdo barrë apo pretendim, kur t'i dorëzohen EBRD-së dhe IFC-së.

e) Përveç shitjes së aksioneve EBRD dhe atyre IFC EBRD-së dhe IFC-së, siç parashikohet në kushtet e Marrëveshjes, nuk ka garanci, peng, të drejta të tjera blerjeje ose zotërimi apo të drejta parablerjeje mbi emetimin ose shitjen e aksioneve përveç atyre në zbatim të dokumenteve të projektit.

f) Licenca e sigurimit është nxjerrë dhe mbahet në mënyrë të vlefshme nga Shoqëria. Ajo lejon Shoqërinë të kryejë aktivitet tregtar sigurimesh në Shqipëri, në përputhje me ligjin për sigurimet.

g) Shoqëria nuk ka filiale të tjera përveç INSIG Makedonia sh.a., Shkup dhe Shoqërisë së Sigurimit INSIG Kosovë. Përveç sa përshkruhet me hollësi në letrën e informacionit të Shoqërisë, Shoqëria nuk ka letra me vlerë të lëshuara nga persona juridikë të tjerë apo subjekte shtetërore. Shoqëria nuk është ortakë apo pjesëmarrëse në ndonjë shoqëri të përbashkët ose ortakëri të çfarëdo lloji.

h) Për sa ka dijeni Shitësi, informacioni që përmban letra e informacionit të Shoqërisë në datën e kësaj Marrëveshjeje është i vërtetë, i plotë dhe i saktë në të gjitha aspektet dhe letra e informacionit të Shoqërisë nuk përmban asnjë deklaratë të pavërtetë ose çorientuese dhe nuk i shmanget ndonjë fakti, i cili do t'i bënte deklaratimet në të, të pavërteta ose çorientuese. Në masën që çdo informacion në letrën e informacionit të Shoqërisë, lidhet me parashikime ose projekte të ngjarjeve të së ardhmes, është e vërtetë që këto parashikime dhe projekte janë përgatitur në mirëbesim, duke pasur parasysh në mënyrë të kujdesshme dhe të drejtë të gjithë faktorët ndikues dhe bazuar në supozime që ishin të arsyeshme në kohën që këto parashikime dhe projektme u përgatitën dhe nuk ka pasur asgjë që nga data e përgatitjes së këtyre parashikimeve dhe projekteve që do t'i bënte ato të paarsyeshme.

i) Deklaratat financiare të Shoqërisë të 31 dhjetorit 2002 për mbylljen e vitit financiar në këtë datë, të certifikuar nga ekspertët kontabël, bëjnë një paraqitje të vërtetë dhe të drejtë të situatës financiare të Shoqërisë në datën e deklaratave financiare dhe ishin përgatitur në përputhje me IAS. Përveç sa deklarohet në këto deklarata financiare, Shoqëria nuk ka asnjë detyrim të mundshëm me rëndësi, detyrime për taksa ose angazhime të mëparshme të pazakonta ose afatgjata, të pashprehura në këto deklarata financiare ose të rezervuara ndaj tyre. Që prej datës së këtyre deklaratave financiare, Shoqëria nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm negativ në biznesin, aktivitetet ose kushtet financiare, nuk ka pësuar ndonjë humbje ose detyrim të rëndësishëm apo të pazakontë, ndërmarrë apo pranuar të ndërmarrë ndonjë detyrim të rëndësishëm apo të pazakontë përveç në zbatim të dokumenteve të projektit.

j) Deklaratat financiare të dorëzuara në përputhje me nenin 6.03(a), të certifikuar nga ekspertët kontabël, bëjnë një paraqitje të vërtetë dhe të drejtë të situatës financiare të Shoqërisë në datën e këtyre deklaratave dhe do të përgatiten në përputhje me IAS. Përveç sa deklarohet në këto deklarata financiare, Shoqëria nuk do të ketë asnjë detyrim të mundshëm me rëndësi, detyrime për taksa ose angazhime të mëparshme të pazakonta ose afatgjata të pashprehura në këto deklarata financiare apo të rezervuara ndaj tyre.

k) Përveç sa deklarohet në letrën e informacionit të Shoqërisë, për sa ka dijeni Shitësi, aktivet e Shoqërisë janë të lira nga çdo kufizim ose detyrim, i cili ka ose mund të ketë me kalimin e kohës efekt të ndjeshëm negativ mbi aktivitetet dhe ligjet e mbrojtjes së mjedisit. Përveç sa deklarohet në letrën e informacionit të Shoqërisë, për sa ka dijeni Shitësi, aktivet e Shoqërisë nuk janë objekt i ndonjë barre dhe shoqëria nuk i nënshtrohet ndonjë kontrate, rregullimi ose ligji, pavarësisht nëse me kusht apo pa kusht, në zbatim të të cilit mund të krijohet ndonjë barrë mbi aktivet e saj.

l) përveç sa deklarohet në letrën e informacionit të Shoqërisë, për sa ka dijeni Shitësi. Shoqëria nuk shkel ndonjë ligj aktualisht në fuqi. Përveç sa deklarohet në letrën e informacionit të Shoqërisë, as Shoqëria (për sa ka dijeni Shitësi) dhe as Shitësi nuk janë në dijeni se është propozuar apo në mënyrë të arsyeshme pritet të propozohet një ligj, i cili do të kishte efekt material negativ mbi biznesin e Shoqërisë, projektin, aktivitetet, situatën financiare të Shoqërisë apo aftësinë e saj për të zbatuar ndonjë nga detyrimet e saj sipas ndonjë Marrëveshjeje, në të cilën ajo është palë. Përveç sa deklarohet në letrën e informacionit të Shoqërisë, të gjitha deklaratat tatimore dhe raportet e Shoqërisë, të parashikuara nga ligji i zbatueshëm për t'u dorëzuar janë dorëzuar rregullisht dhe të gjitha vlerësimet e tatimeve, tarifat dhe detyrimet e tjera shtetërore mbi Shoqërinë, aktivet dhe të ardhurat e saj, të cilat janë të detyrueshme dhe të pagueshme, janë paguar përveç atyre aktualisht të pagueshme pa gjobë apo interes. As Shitësi, as Shoqëria, për sa ka dijeni Shitësi, as ndonjë nga zyrtarët përkatës, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës ose punonjësit e autorizuar, agjentët apo përfaqësuesit:

i) nuk ka paguar apo marrë, premtuar ose ofruar për të paguar, autorizuar pagesën e ndonjë komisioni, mite, shpërblimi ose bakshishi në lidhje me biznesin ose operacionet financiare të Shoqërisë ose projektit që shkel ndonjë ligj në zbatim apo ka hyrë në ndonjë marrëveshje në zbatim të së cilës ndonjë komision, mitë, shpërblim ose bakshish mund ose do të paguhet në çdo kohë ose

ii) nuk ka ofruar ose dhënë ndonjë gjë me vlerë për të influencuar veprimin e zyrtarit publik, kërcënuar me dëmtim personi, pronësie, reputacioni, në lidhje me biznesin ose operacionet financiare të Shoqërisë ose projektit për të përfutur ose mbajtur biznesin ose ndonjë avantazh tjetër të padrejtë në rrjedhën e biznesit.

m) Përveç sa shprehet në letrën e informacionit të Shoqërisë, për sa ka dijeni Shitësi, Shoqëria nuk ka detyrime të prapambetura sipas ndonjë marrëveshjeje borxhi apo detyrimi, palë e të cilit ajo është apo me të cilin është e lidhur ajo ose ndonjë nga pronat apo aktivet e saj dhe nuk ekziston asnjë rast vonese në pagim apo me aq sa njihet, nuk ka asnjë rast potencial ku në bazë të ndonjë marrëveshjeje Shoqëria të ketë detyrime të prapambetura. Përveç sa shprehet letra e informacionit të Shoqërisë, për sa ka dijeni Shitësi, as Shoqëria as ndonjë nga zyrtarët e saj apo me aq sa ka dijeni shitësi, asnjë agjent ose punonjës (gjatë ushtrimit të funksionit të tyre) nuk ka bërë apo pranuar të bëjë diçka në kundërshtim me të drejtën në zbatim, duke përbërë kështu shkak për vendosjen e ndonjë gjobe detyrimi ose dënimi për shoqërinë që të kalojë shumën ekuivalente të US \$ 10.000.

n) Përveç sa shprehet në letrën e informacionit të Shoqërisë për sa ka dijeni Shitësi, Shoqëria dhe bizneset e saj, operacionet, aktivet, pajisjet, pronat, qiramarrjet dhe objektet e tjera janë në përputhje me dispozitat e të gjitha ligjeve për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë. Shoqëria ka nxjerrë të gjitha autorizimet e kërkuara në lidhje me shpërndarjen në ajër, shkarkimet në ujërat sipërfaqësore ose nëntokësore, përhapjet e zhurmave, hedhjen e mbeturinave të ngurta e të lëngshme, përdorimin, prodhimin, magazinimin, transportimin apo hedhjen e lëndëve ose mbeturinave toksike ose të rrezikshme, si dhe me çdo çështje tjetër mjedisore, shëndetësore apo të sigurisë dhe për këto autorizime nuk ka marrë asnjë ankesë, urdhër, direktivë, pretendim, thirrje për gjyq apo paralajmërim nga ndonjë subjekt shtetëror ose person tjetër. Përveç sa deklarohet në letrën e informacionit të Shoqërisë, as Shoqëria, dhe as Shitësi nuk është në dijeni të ndonjë fakti që mund të përbente shkak për çështjet gjyqësore ose procedim administrativ kundër Shoqërisë.

o) Veç çështjeve të shprehura me hollësi në letrën e informacionit të Shoqërisë, për sa ka dijeni Shitësi, Shoqëria nuk është e angazhuar dhe as në dijeni të ndonjë kërcënimi me çështje gjyqësore, arbitrazhi ose procedimi administrativ, rezultati i të cilit mund të ketë efekt negativ të rëndësishëm mbi projektin, biznesin e Shoqërisë, operacionet ose situatën financiare apo aftësinë e Shoqërisë për të kryer ndonjë nga detyrimet e saj sipas ndonjë marrëveshjeje në të cilën ajo është palë.

p) Përveç sa shprehet në letrën e informacionit të Shoqërisë, i gjithë informacioni i nevojshëm, njoftimet, llogaritë, deklaratat, raportet, njehsimet dhe deklaratat tatimore që mund të jenë bërë apo dhënë, janë dorëzuar rregullisht dhe saktësisht nga Shoqëria në organet fiskale kompetente në Republikën e Shqipërisë ose diku tjetër dhe i gjithë informacioni, njoftimet, njehsimet, dhe deklaratat tatimore janë të vërteta dhe të sakta, nuk janë dhe as ka gjasa të bëhen objekt i ndonjë konflikti serioz me këto organe.

q) Gjithë taksat e çfarëdo natyre në Republikën e Shqipërisë apo diku tjetër për të cilat detyrohet Shoqëria, janë paguar plotësisht (aq sa mund të jenë paguar deri tani) dhe pa paragjykuar gjeneralitetin e atyre që janë në vazhdim. Shoqëria ka bërë uljet dhe mbajtjet që ishte e detyruar apo kishte të drejtë të bënte dhe të gjitha pagesat si duheshin bërë.

r) Përveç sa shprehet në letrën e informacionit të Shoqërisë, Shoqëria është në përputhje me të gjitha ligjet e zbatueshme dhe praktikën në lidhje me punësimin, kushtet dhe kufizimet e punësimit duke përfshirë pa u kufizuar në to, dispozitat në lidhje me pagat, shpërblimet, orët e punës dhe kontributet e sigurimeve sociale, kujdesin shëndetësor dhe sigurimet për sigurinë në punë.

Neni 2.03

Deklarime për këtë Marrëveshje

Shitësi i deklaron dhe garanton çdo blerës se:

a) Ka tagrat dhe kompetencat për të nënshkruar këtë marrëveshje dhe, me miratimin nga Kuvendi dhe botimin në Fletoren Zyrtare të ligjit përkatës që miraton këtë Marrëveshjeje, Ministri i Financave (në emër të shitësit) ka tagrat dhe kompetencat për të zbatuar këtë Marrëveshje.

b) Me nënshkrimin nga palët e tjera dhe dorëzimin e saj, miratimin e saj nga Kuvendi dhe publikimin e ligjit përkatës që miraton këtë Marrëveshjeje në Fletoren Zyrtare, kjo Marrëveshje bëhet rregullisht e autorizuar dhe e dorëzuar nga Shitësi, duke vendosur detyrime të vlefshme dhe juridikisht shtrënguese për Shitësin, të zbatueshme në përputhje me kushtet e saj. Lidhja e kësaj Marrëveshjeje dhe përputhja me kushtet e saj:

i) nuk vjen në kundërshtim me asnjë dispozitë të ligjeve të tjera të detyrueshme për Shitësin, Shoqërinë ose shtetin shqiptar ose me ndonjë traktat ndërkombëtar që ka detyrime për Shitësin ose shtetin shqiptar;

ii) nuk vjen në kundërshtim me dispozitat e marrëveshjeve ose instrumenteve ku Shitësi, Shoqëria është palë ose me të cilat lidhen aktive të saj dhe se lidhja e saj nuk kërkon ndonjë miratim sipas atyre marrëveshjeve dhe as nuk krijon ndonjë barrë sipas tyre;

iii) nuk sjell mospërmbushje ose ngjarje sipas së cilës, pas dhënies së njoftimit, kalimi i kohës ose marrja e një vendimi ose kombinimi i tyre do të sillte mospërmbushje të kushteve të marrëveshjes ose instrumentit.

c) Nuk kërkohet asnjë autorizim tjetër për lidhjen, dorëzimin, zbatimin nga Shitësi apo për vlefshmërinë e kësaj Marrëveshjeje ose dokumenteve të projektit, veç miratimit të Marrëveshjes së aksionarëve dhe kësaj Marrëveshjeje nga Kuvendi dhe botimit të ligjit përkatës për miratimin e Marrëveshjes së rishitjes, Marrëveshjes së aksionarëve dhe kësaj Marrëveshjeje në Fletoren Zyrtare.

d) Asnjë pullë, taksë tjetër ose tatim nga ndonjë subjekt shtetëror, organ taksash, federatë apo shoqatë, anëtare e së cilës është Republika e Shqipërisë, nuk mund të vendoset, as për efekt të nënshkrimit, dorëzimit ose zbatimit të Marrëveshjes apo ndonjë transaksioni të parashikuar aty për sigurimin e ligjshmërisë, vlefshmërisë, zbatueshmërisë ose pranueshmërisë të kësaj Marrëveshjeje, në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2.04

Pohime dhe garanci

Shitësi njeh faktin që ka bërë deklaratimet dhe garancitë në nenin 2.01, nenin 2.02 dhe nenin 2.03, me qëllimin për të bindur çdo blerës të hyjë në këtë Marrëveshje dhe që çdo blerës ka hyrë në këtë Marrëveshjeje në bazë dhe duke besuar te secila nga këto deklaratime dhe garanci. Shitësi garanton që secili nga këto deklaratime dhe garanci është i vërtetë dhe korrekt dhe që nuk ka dijeni mbi ndonjë fakt apo çështje shtesë, moskryerja e së cilës e bën ndonjë nga këto deklaratime apo garanci çorientuese apo e cila do të ndikojë ose, në mënyrë të arsyeshme mund të pritët të ndikojë gjykimin e ndonjë blerësi të ardhshëm për sa i përket blerjes së aksioneve në shitje. Blerësit njohin faktin që ata nuk kanë besuar në asnjë garanci apo deklaratim bërë nga Shitësi apo në emër të tij, përveç atyre të parashikuara në dokumentet e projektit.

Neni 2.05

Deklarime dhe garanci të Blerësit

Secili blerës i deklaron dhe garanton Shitësit se:

a) Ai ka tagrin dhe kompetencën për të hyrë në këtë Marrëveshjeje dhe zbatuar atë.

b) Ka siguruar të gjitha autorizimet e nevojshme për nënshkrimin, dorëzimin ose zbatimin e rregullt prej tij të Marrëveshjes.

c) Kjo Marrëveshjeje konstituon detyrime të vlefshme dhe juridikisht shtrënguese për Blerësin dhe lidhja e kësaj Marrëveshjeje dhe përputhja me kushtet e saj:

i) nuk vjen në kundërshtim me ndonjë dispozitë të ndonjë ligji ose traktati ndërkombëtar të zbatueshëm për këta blerës;

ii) nuk vjen në kundërshtim apo rezulton në shkelje të ndonjë dispozite të ndonjë marrëveshjeje apo instrumenti ku blerësi është palë, ose me të cilën blerësi apo ndonjë nga aktivet e tij është i lidhur dhe as kërkon ndonjë miratim apo vendos ndonjë barrë në zbatim të kësaj Marrëveshjeje ose instrumenti;

iii) nuk përbën vonesë në pagim apo një rast ku me dhënien e njoftimit, kalimin e kohës apo marrjen e vendimit, si dhe me ndonjë kombinim të këtyre, do të përbënte vonesë në pagim sipas kësaj Marrëveshjeje ose instrumenti.

Neni 2.06

Procedura e pretendimeve

a) Pavarësisht nga çfarë përmban kjo Marrëveshje, blerësit nuk kanë të drejtë të bëjnë ndonjë pretendim ndaj Shitësit përsa i përket ndonjë garancie, nëse blerësi përkatës nuk i ka bërë njoftim me shkrim Shitësit (duke përcaktuar në detaje të arsyeshme bazat e këtij pretendimi dhe shumën e përfshirë dhe duke iu referuar çështjeve mbi të cilat mbështetet) në ose para përvjetorit të dytë të datës së transferimit dhe ky pretendim do të konsiderohet i rrëzuar (nëse nuk ka qenë më parë i përmbushur apo rrëzuar) nëse nuk është lajmëruar procedimi ligjor për këtë kundër Shitësit brenda tre muajve nga dhënia e njoftimit të përmendur më sipër.

b) Blerësin nuk do ta autorizojë çdo garanci e shkelur për kompensim në nivelin që mund të rivendoset në vend, nëse Shitësit nuk i jepet njoftim me shkrim për këtë shkelje dhe kjo shkelje nuk është vënë në vend brenda 30 ditëve pas datës që ky njoftim i është dorëzuar Shitësit.

c) Blerësit zotohen që të njoftojnë menjëherë Shitësin me shkrim për çdo pretendim ose çështje që vjen në dijeni të tyre dhe që ka mundësi të shkaktojë ngritjen e ndonjë pretendimi nga blerësit ndaj Shitësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

d) Në çdo procedim të ngritur kundër Shitësit ose Shoqërisë për ndonjë pretendim për dëme, arbitrave ose gjykatësve sipas rastit, do t'u kërkohet të vendosin duke marrë parasysh të gjithë informacionin përkatës në lidhje me këtë pretendim duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

i) pasojat pozitive dhe negative të ngjarjeve që përbëjnë shkak për shkelje të garancisë;

ii) nivelin në të cilin dëmet e pësura nga Shoqëria ose Blerësi janë zhdëmtuar nga të tretët në mënyra të ndryshme;

iii) nivelin në të cilin dëmi, në rastin e pretendimeve të shumëfishta, mund të rezultojë nga e njëjta ngjarje;

iv) nivelin në të cilin është e drejtë të shpërblehen dëmet, për sa i përket përgjegjësisë së mundshme, e cila nuk është bërë përgjegjësi reale në kohën e procedimit në fjalë;

v) nivelin në të cilin janë zhdëmtuar dëmet si pjesë e pagesës së shumës së korrigjimit të çmimit në përputhje me nenin 3.05;

vi) nivelin në të cilin dëmet mund të rezultojnë nga ndonjë veprim ose mosveprim i kryer me miratimin e blerësve ose pas datës së transferimit;

vii) nivelin në të cilin ndonjë pretendim mund të rritet apo reduktohet nga ndonjë pasaktësi në deklaratat financiare të 31 dhjetorit 2002.

KREU III

SHITJA E AKSIONEVE

Neni 3.01

Transferimi i aksioneve

a) Sipas kreut VI, Shitësi do t'i shesë:

i) EBRD-së dhe EBRD do të blejë nga Shitësi dhe do të paguajë plotësisht, në përputhje me nenin 3.03, aksionet EBRD me të gjitha të drejtat bashkëlidhur; dhe

ii) IFC-së dhe IFC do të blejë nga Shitësi dhe do të paguajë plotësisht, në përputhje me nenin 3.03, aksionet IFC me të gjitha të drejtat bashkëlidhur.

b) Shitësi bie dakord me secilin nga blerësit për sa vijon:

i) ai ka të drejtën t'i shesë dhe t'i transferojë EBRD-së dhe IFC-së titull pronësie të plotë mbi aksionet EBRD dhe IFC, përkatësisht në përputhje me këtë Marrëveshjeje; dhe

(ii) me transferimin apo pas tij, do të nënshkruajë dhe do të përgatisë, me kostot dhe shpenzimet e saj, të gjitha ato dokumente, akte apo dhe të tjera që mund të kërkohen për të veshur EBRD dhe IFC me pronësinë e aksioneve EBRD dhe IFC (apo përfaqësuesit e tyre) sipas rastit.

c) Aksionet EBRD dhe IFC do të shiten të lira nga çdo barrë apo e drejtë e ushtrueshme e të tretëve.

d) Asnjë nga blerësit nuk detyrohet të përfundojë blerjen e ndonjë prej aksioneve në shitje, nëse blerësi tjetër gjithashtu nuk përfundon blerjen e aksioneve të tij në shitje në përputhje me Marrëveshjen.

e) Palët do të nënshkruajnë pa vonesë të panevojshme të gjitha dokumentet dhe do të bëjnë të gjitha deklaratat e nevojshme për të çuar dhe (nëse është e nevojshme) plotësuar kërkesën për urdhrin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, referuar në nenin 6.03 (f).

Neni 3.02

Çmimi i blerjes

Pavarësisht nga dispozitat e korigjimit të çmimit në nenin 3.05 dhe pa paragjykim ndaj këtij korigjimi, EBRD dhe IFC do të paguajnë secili çmimin fillestar të blerjes për aksionet EBRD dhe IFC në *cash* në përputhje me dispozitat e nenit 3.03.

Neni 3.03

Procedurat për blerjen dhe dorëzimin e aksioneve

a) Në zbatim të plotësimit të kërkesave të parashtruara në kreun VI (të ndryshme nga dispozitat e nenit 6.13) dhe dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje, Shitësi dorëzon tek secili nga EBRD dhe IFC një kërkesë për pagim dhe nënshkrim në formën bashkëlidhur në shtojcën C, duke përcaktuar datën e transferimit, e cila nuk mund të jetë para dhjetë (10) ditësh-pune duke filluar nga data në të cilën EBRD dhe IFC morën këtë kërkesë (Kërkesë për pagim dhe nënshkrim).

b) Në datën e transferimit, referuar në kërkesën për pagim dhe nënshkrim, Shitësi do t'i dorëzojë ose do të bëjë të mundur dorëzimin secilit nga EBRD apo IFC, ose sipas udhëzimeve të EBRD dhe IFC ekstrakte të nxjerra nga qendra për regjistrimin e aksioneve, që tregojnë që aksionet EBRD janë regjistruar në emrin e EBRD ose në emrin e personit të njoftuar paraprakisht nga EBRD Shitësit me shkrim dhe aksionet IFC janë regjistruar në emrin e IFC ose të personit të njoftuar më parë Shitësit nga IFC me shkrim dhe këto ekstrakte nuk do të tregojnë nëse ndonjë nga aksionet në shitje është peng ose i ngarkuar në ndonjë mënyrë tjetër.

c) Pas marrjes së ekstrakteve të referuara në nenin 3.03 (b), secili prej EBRD-së dhe IFC-së do të bëjë të mundur pagimin e çmimit fillestar të blerjes Shitësit, në përputhje me udhëzimet e Shitësit të parashtruara në kërkesën përkatëse për pagim. Çmimi fillestar i blerjes për t'u paguar nga secila, EBRD dhe IFC, do të jetë një shumë në dollarë e përcaktuar, bazuar në mestaren e kursit ditor zyrtar dollarë/lekë publikuar nga Banka e Shqipërisë gjatë një periudhe pesë (5) ditë-pune, menjëherë pas ditës që është dy (2) ditë-pune para datës së transferimit paguar Shitësit në fonde menjëherë të disponueshme.

d) Nëse për ndonjë arsye dispozitat e nenit 3.03 nuk zbatohen plotësisht në datën e transferimit, përcaktuar në kërkesën për pagim dhe nënshkrim, Shitësit do të caktojnë bashkërisht një datë tjetër për transferimin jo më larg se 3 janar 2004.

Neni 3.04
Garancitë e mëtejshme

Kohë pas kohe pas datës së transferimit, çdo palë do të nënshkruajë dhe do të dorëzojë instrumente të tjera transferimi dhe kalimi, me kërkesën e ndonjëres nga palët dhe pa shqyrtime të mëtejshme (përveç atyre të paraqitura në nenin 3.03) dhe ndërmarrë të tjera veprime të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga pala tjetër për transferim më efektiv të aksioneve në shitje në përputhje me nenin 3.01.

Neni 3.05
Korrigjimi i çmimit

a) Nëse (i) gjatë një periudhe njëvjeçare pas datës së transferimit, EBRD dhe IFC vijnë në dijeni të ndonjë informacioni negativ të rëndësishëm për biznesin dhe operacionet e Shoqërisë, i cili nëse do të kish qenë i njohur për Shoqërinë, Shitësin, EBRD-në apo IFC-në në datën e transferimit apo para saj, do të kish rezultuar në përcaktimin e një vlere kontabile për aksion më të ulët se ajo ku u bazua çmimi fillestar i blerjes, i paguar nga EBRD apo IFC ("Rasti i korrigjimit të çmimit të situatës financiare") apo (ii) shitja e aksioneve nga shitësi investitorit strategjik, gjatë një periudhe 2-vjeçare siç parashikohet gjatë rrjedhës së projektit, është bërë në kushtet thelbësisht më të favorshme financiare sesa shitja e aksioneve EBRD dhe IFC, përkatësisht EBRD-së dhe IFC-së ("Rasti i korrigjimit të çmimit të investitorit strategjik"), Shitësi do t'i paguajë secilit, EBRD-së dhe IFC-së brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e njoftimit nga blerësi përkatës, "Shumën e korrigjimit të çmimit", përcaktuar në përputhje me paragrafin (b) në vazhdim.

b) Shuma e korrigjimit të çmimit për t'iu paguar secilit nga EBRD dhe IFC do të jetë e barabartë me:

i) Në rastin e korrigjimit të çmimit të situatës financiare, (x) diferencën e përfituar duke zbritur vlerën kontabile për aksion nga vlera e korrigjuar për aksion (y) shumëzuar me numrin e aksioneve EBRD dhe IFC sipas rastit në interes të llogaritur nga dhe duke përfshirë datën e transferimit në normën e interesit të korrigjimit të çmimit. Për qëllim të këtij paragrafi 3.05 (b)(i), "Vlera e korrigjuar për aksion" do të jetë një shumë e përcaktuar në lekë e barabartë me (i) vlerën e aktiveve të Shoqërisë në datën e transferimit minus gjithë detyrimet e Shoqërisë deri në datën e transferimit, në të dy rastet rivlerësuar si në datën e transferimit, siç përcaktohet nga ekspertët kontabël të pavarur emëruar nga EBRD dhe IFC në përputhje me nenin 3.05 (e) pjesëtuar me (ii) numrin e aksioneve ekzistuese.

ii) në rastin e korrigjimit të çmimit të investitorit strategjik, (x) diferenca e përfituar duke zbritur vlerën kontabile për aksion nga çmimi për aksion i paguar shitësit nga investitori strategjik (dhe nëse ky çmim nuk është përcaktuar në lekë ekuivalencën në lekë të kësaj shume (y) shumëzuar me numrin e aksioneve EBRD dhe IFC sipas rastit me interes të llogaritur nga dhe duke përfshirë datën e transferimit në normën e interesit të korrigjimit të çmimit.

c) EBRD-së dhe IFC-së nuk do t'u paguhet shumë korrigjimi çmimi, nëse shuma agregate e korrigjimit të çmimit e llogaritur në përputhje me nenin 3.05(b) dhe 3.05(d) është më e vogël se 200 000 (dyqind mijë) dollarë.

d) Shuma e korrigjuar e çmimit për t'iu paguar EBRD-së dhe IFC-së do të jetë në dollarë dhe e përcaktuar bazuar në normën zyrtare të shkëmbimit dollarë/lekë, publikuar nga Banka e Shqipërisë gjatë periudhës prej pesë (5) ditëve-pune para datës që bie dy (2) ditë-pune para datës në të cilën është bërë pagesa.

e) (i) Ekspertët kontabël të pavarur, referuar në nenin 3.05(b) (I) do të caktohen nga marrëveshja reciproke e të gjitha palëve. Ekspertët kontabël të pavarur do të veprojnë si ekspertë dhe jo arbitra dhe do t'u kërkohej nga palët të marrin vendim brenda 30 ditëve nga caktimi. Përveç në rastet e gabimeve të dukshme, vendimet e tyre do të jenë përfundimtare dhe të detyrueshme për palët. Kostoja e ekspertëve kontabël të pavarur do të paguhet nga Shoqëria.

ii) Nëse Palët nuk janë të afta të bien dakord mbi identitetin e këtyre ekspertëve brenda 7 ditëve-pune pas dorëzimit të njoftimit nga një palë te pala tjetër për të rënë dakord, ekspertët do të caktohen, me kërkesën e cilësdo palë nga presidenti i radhës i Institutit të Ekspertëve Kontabël të autorizuar për Anglinë dhe Uellsin, i cili do të veprojnë si ekspert dhe jo si arbitër dhe do t'i kërkohej nga palët të marrë vendimin brenda 30 ditëve nga emërimi. Vendimi i tij do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për palët. Kostoja e këtij eksperti do të paguhet nga Shoqëria.

iii) Për marrjen e vendimeve të tyre në përputhje me nenin 3.05 (b)(i) ekspertëve të pavarur do t'u kërkohej nga palët të kërkojnë pranim me shkrim nga secila prej palëve para nxjerrjes së përfundimeve të tyre.

KREU IV DETYRIME POZITIVE

Neni 4.01 Ushtrimi i biznesit

Në periudhën midis datës së kësaj Marrëveshjeje dhe transferimit, nëse blerësi nuk do të kërkojë ndryshe me shkrim, Shitësi do ta nxitë Shoqërinë të veprojë si më poshtë:

a) të ushtrojë biznesin e saj në mënyrë të efektshme, të shëndetshme dhe në përputhje me deklaratën e politikës operative;

b) të bëjë maksimumin e përpjekjeve për të ruajtur të paprekur organizimin e biznesit të saj, të mbajë të disponueshëm zyrtarët, agjentët, punonjësit e saj aktualë (përveç kur kjo nuk përputhet me dokumentet e projektit) dhe për të ruajtur besimin e të gjithë klientëve, risiguruesve, furnizuesve dhe të tjerëve, me të cilët ka marrëdhënie biznesi;

c) të ketë funksionale dhe të mirëmbajë në çdo kohë marrëveshjet e pranueshme nga blerësit që mbulojnë pronat e Shoqërisë dhe biznesin nga humbja, dëmtimi ose/apo mashtrimi dhe *inter alia* marrëveshjet e duhura të risigurimit, të pranueshme për blerësit, të cilat mbulojnë ekspozimin e klientëve apo humbje të tjera në biznes;

d) t'u lejojë blerësve dhe përfaqësuesve të tyre të autorizuar akses të plotë në gjitha pronat, aktivet, të dhënat, deklaratat tatimore, kontratat dhe dokumentet e saj, si dhe të dorëzojë te blerësit apo përfaqësuesit e tyre të autorizuar këto dhe informacione të tjera në lidhje me biznesin apo aktivet sipas kërkesës së blerësve kohë pas kohe;

e) të krijojë dhe të mbajë procedura të brendshme të pranueshme nga blerësi me qëllim parandalimin e shndërrimit të Shoqërisë në instrument për pastrim parash, mashtrim apo veprimtari të tjera korruptive ose të jashtëligjshme (Politika antipastrim parash);

f) të mbajë sistem kontabiliteti dhe kontrolli, sistem informimi mbi menaxhimin, libra kontabiliteti dhe të dhëna të tjera, të cilat së bashku pasqyrojnë drejt dhe vërtetësisht situatën financiare të Shoqërisë dhe rezultatet e operacioneve të saj;

g) të mbajë ekspertë kontabël të pavarur, të pranuar nga blerësit dhe t'i autorizojë ata të komunikojnë drejtpërdrejt me blerësit;

h) të përfitojë dhe të mbajë të vlefshme të gjitha autorizimet;

i) të veprojë në përputhje me ligjin e zbatueshëm, duke përfshirë të gjithë ligjet për sigurimet dhe kërkesat rregulluese të përcaktuara nga rregullatori i sigurimeve, si dhe të autorizojë blerësit të komunikojnë drejtpërdrejt me rregullatorin e sigurimeve në çdo kohë, për përputhjen e Shoqërisë me këto ligje dhe rregullore dhe çdo çështje tjetër;

j) të zhvillojë biznesin e saj duke u kujdesur për mjedisin, për shëndetin, sigurinë publike e profesionale në përputhje me udhëzimet për mjedisin, rregulloret dhe standardet mjedisore në fuqi kohë pas kohe në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4.02
Investitori strategjik

Shitësi merr përsipër dhe bie dakord me blerësin që në rast se shitja dhe transferimi i aksioneve nga Shitësit tek investitori strategjik kërkon ndonjë garanci financiare apo rritje krediti të Shitësit (apo të ndonjë personi tjetër) për të kompensuar investitorin strategjik për borxhe apo humbje të tjera financiare, kosto dhe shpenzime të krijuara nga Shoqëria. Shitësi merr përsipër dhe pranon t'i ofrojë blerësit garanci financiare apo rritje krediti *pro rata*, në esencë me të njëjtat kushte si ato të ofruara investitorit strategjik.

Neni 4.03
Shkelja e deklarimeve dhe garancive

Menjëherë me marrjen dijeni nga Shitësi, para transferimit, të afrimit apo kërcënimit për ndodhjen e ndonjë ngjarjeje, e cila do të shkaktoje apo përbënte shkelje apo një ngjarje e ndodhur apo e ditur nga Shitësi para datës së kësaj Marrëveshjeje, që do të kishte shkaktuar apo përbërë shkelje të ndonjë garancie, Shitësi do t'i japë secilit prej blerësve njoftim me shkrim të detajuar në mënyrë të arsyeshme dhe secili prej blerësve (i) do të jetë juridikisht i aftë të bëjë përpjekje të arsyeshme për të parandaluar apo ndrequr sa të jetë e mundur ose (ii) në zgjedhjen e tij të ketë të drejtë të zgjidhë këtë Marrëveshje.

Neni 4.04
Tatimet

Shitësi do të paguajë apo do të nxitë të paguhen të gjitha taksat aktuale dhe të ardhshme, tatime, fatura dhe detyrime të tjera të çfarëdo natyre, së bashku me interesat apo gjoba në lidhje me to tani apo në çdo kohë këtej e tutje, të mbledhura këto apo të vendosura nga Republika e Shqipërisë, ose ndonjë subjekt shtetëror a organizatë, anëtare e së cilës është Republika e Shqipërisë në lidhje me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje.

KREU V
DETYRIME NEGATIVE

Neni 5.01
Ushtrimi i biznesit

Midis datës së Marrëveshjes dhe transferimit, nëse blerësit nuk kërkojnë ndryshe me shkrim, Shitësi do të nxitë Shoqërinë të mos:

a) deklarojë, shfuqizojë, paguajë ndonjë dividend apo bëjë ndonjë shpërndarje të kapitalit të saj të emetuar dhe autorizuar;

b) hyjë në ndonjë marrëveshje apo ujdj sipas së cilës ajo merr përsipër përgjegjësi të mundshme si garantuese apo tjetër lloj (të ndryshme nga kontratat e sigurimeve në të cilat hyn gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit) apo në ndonjë rrethanë tjetër bëhet e detyruar për të gjithë apo një pjesë të ndonjë detyrimi financiar ose jofinanciar të një personi tjetër;

c) krijojë, regjistrojë apo lejojë ekzistencën e ndonjë barre mbi ndonjë aksion apo pronë, të ardhura, aktive të tjera të tashme apo të ardhshme të saj;

d) hyjë në ndonjë normë interesi apo ndërrimi monedhe, normë interesi tavan, marrëveshje mbi normat e transferimit apo normë tjetër interesi, mbrojtje monedhe mallrash apo transaksione të ngjashme rrjedhëse, përveçsa mund të lejohet në përputhje me udhëzimet për menaxhimin e aktiveve/detyrimeve parashikuar në deklaratën e politikës operative;

e) hyjë në ndonjë transaksion me ndonjë person, përveçse në rrjedhën e zakonshme të biznesit, me kushte të zakonshme tregu dhe në bazë të marrëveshjeve të brendshme, hyjë në ndonjë transaksion sipas të cilit Shoqëria do të paguante më tepër se çmimi i pranueshëm brenda

udhëzimeve të zbatueshme sipas ligjit të zbatueshëm për çdo blerje apo do të përfitonte një çmim më të vogël se ai i plotë i tregut për produktet apo shërbimet e saj, apo hyjë në ndonjë transaksion që përmban shitjen e ndonjë prej aktiveve të saj me një vlerë më të madhe se pesë për qind (5%) të vlerës neto të aktiveve;

f) hyjë në ndonjë ortakëri, marrëveshje për ndarje fitimesh, shfrytëzim pronësie apo ujdj të ngjashme, sipas së cilës të ardhurat apo përfitimet e shoqërisë janë ndarë apo mund të ndahen me ndonjë person tjetër (e ndryshme nga marrëveshjet për pagimin e komisionit të brokërimit agjentëve të sigurimeve);

g) hyjë në ndonjë kontratë menaxhimi apo të ngjashme, sipas së cilës ndonjë person, i ndryshëm nga ai i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, menaxhon biznesin apo operacionet e saj;

i) ndërmarrë ndonjë veprim që nuk do të ishte në përputhje me deklaratën e politikës operative (duke përfshirë pa kufizim përputhjen me udhëzimet dhe raportet financiare parashikuar aty), udhëzimet për mjedisin, politikën antipastrim parash dhe ndonjë tjetër dokument të projektit;

j) bëjë ndonjë ndryshim në natyrën e biznesit apo operacioneve të tij apo të ndërmarrë ndonjë aktivitet tregtar tjetër veç ofrimit të sigurimeve apo shërbimeve financiare të lidhura me këtë, drejtpërdrejt apo nëpërmjet ndonjë filiali;

k) ndryshojë emrin e saj;

l) bëjë ndonjë ndryshim apo të lejojë bërjen e ndonjë ndryshimi në kapitalin e saj aksionar të autorizuar apo emetuar ose statut, duke e përfshirë pa kufizim rritjen apo zvogëlimin e kapitalit të saj aksionar, riemërtimin e aksioneve të saj, ndikim në ndonjë ndarje të aksioneve apo emetim të aksioneve shpërblim;

m) bëjë ndonjë ndryshim ose të lejojë bërjen e ndonjë ndryshimi në statut ose deklaratën e politikës operative, përveç kur është në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje ose të marrëveshjes së aksionarëve;

n) krijojë apo ketë ndonjë filial, apo bëjë ndonjë investim në aksione të ndonjë personi apo ndërmarrje tjetër (të ndryshme nga INSIG Makedonia sh.a. Shkup dhe Shoqëria e Sigurimit INSIG Kosovë);

o) ndërmarrë apo lejojë ndonjë bashkim, shkrirje apo riorganizim në kundërshtim me këtë Marrëveshje, ndërmarrë apo lejojë shitjen apo dhënien me qira të gjithë, apo esencialisht të gjitha pronave ose aktiveve të saj;

p) kryejë ose moskryejë, apo nxitë, lejojë kryerjen apo moskryerjen e ndonjë akti apo diçkaje, duke rezultuar kështu në (ose do të kishte gjasa të rezultonte në) shkelje të ndonjë prej deklarimeve dhe garancive të bëra në nenin 2.01, nenin 2.02 dhe nenin 2.03;

q) kryejë ose moskryejë, apo nxitë, lejojë kryerjen apo moskryerjen e ndonjë akti apo diçkaje e cila në mënyrë të arsyeshme ka gjasa të shkaktojë ndonjë ndryshim negativ të rëndësishëm në aktivitetin tregtar, operacionet apo situatën financiare, ose rezultojë në pësimin nga Shoqëria të ndonjë humbjeje apo detyrimi të rëndësishëm apo të pazakontë;

r) ndërmarrë apo pranojë të ndërmarrë ndonjë detyrim të rëndësishëm apo të pazakontë, veç sa parashikohet në dokumentet e projektit;

s) bëjë kredi për shtëpi.

Neni 5.02

Kreditë për shtëpi

Blerësit njohin dhe bien dakord që Shoqëria mund t'ia transferojë kreditë për shtëpi një subjekti shtetëror me interes të vogël ose pa interes fare. Pavarësisht ndonjë dispozite tjetër të kësaj Marrëveshjeje apo dokumenti tjetër të projektit, ky transferim nuk do të jetë shkelje e ndonjë deklarami, garancie, detyrimi apo ta zotimi të dhënë në ndonjë dokument të projektit dhe as do t'u japë të drejtë blerësve të zgjidhin apo ta ndërpresin në tjetër mënyrë këtë Marrëveshje.

KREU VI KUSHTE ME PËRPARËSI

Detyrimet e EBRD-së për të blerë aksionet EBRD dhe IFC-së për të blerë aksionet IFC në datën e transferimit do t'i nënshtrohen përmbushjes paraprake të kushteve me përparësi të parashikuara në kreun VI, në çdo rast në formën dhe përmbajtjen e pranuar nga EBRD dhe IFC, nëse prej tyre nuk është hequr dorë me shkrim nga kjo e drejtë.

Neni 6.01 **Ligjet për privatizimin**

Ligjet për privatizimin vazhdojnë veprimin dhe fuqinë e tyre të plotë dhe nëse ndryshohen prej kësaj date, këto ndryshime do të jenë në formën dhe përmbajtjen e pranuar nga blerësit.

Neni 6.02 **Dokumentet e projektit**

Dokumentet e projektit (veç letrës së informacionit të shoqërisë) në formë dhe përmbajtje të pranueshme për blerësit do të kenë bërë palë nënshkrueset dhe do të jenë bërë plotësisht efektive dhe të pakushtëzuara.

Neni 6.03 **Dokumentet**

Blerësi do të ketë marrë dokumentet e mëposhtme:

- a) deklaratat financiare të audituara gjysmëvjetore të Shoqërisë të datës 30 qershor 2003;
- b) letrën e nënshkruar rregullisht të Shoqërisë në përgjigje të letrës së menaxhimit të datës 20 qershor 2003, drejtuar drejtuesve të Shoqërisë nga ekspertët kontabël, në një formë të pranuar nga blerësi;
- c) kopje të noterizuar të licencës së sigurimeve;
- d) letrën e nënshkruar rregullisht të ekspertëve kontabël në formën bashkëlidhur si shtojca B-1;
- e) letrën e rregullatorit të sigurimeve në formën bashkëlidhur si shtojca B-2 të nënshkruar rregullisht;
- f) kopje të noterizuar të urdhrit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, që urdhëron regjistrimin e aksioneve EBRD në emër të EBRD-së dhe regjistrimin e aksioneve IFC në emër të IFC-së.

Neni 6.04 **Autorizimet e Shoqërisë**

Blerësit do të kenë marrë dhe kopje të noterizuara të të gjitha vendimeve të aksionarëve dhe Këshillit Mbikëqyrës për nënshkrim, dorëzim dhe kryerje të rregullt të kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve të tjera të projektit nga Shoqëria ose Shitësi (sipas rastit).

Neni 6.05 **Miratimet e sigurimeve**

Blerësit duhet të kenë marrë origjinalet të nënshkruara rregullisht të miratimit nga rregullatori i sigurimeve të çështjeve si vijon:

- a) çdo blerësi që zotëron më tepër se 10% të kapitalit aksionar të shpallur të Shoqërisë;
- b) personave që blerësit propozojnë t'i emërojnë si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 6.06
Delegimi i tagrave

Blerësit do të kenë marrë origjinalin e delegimit të tagrave të Ministri i Financave për nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6.07
Miratimet nga Kuvendi

Kjo Marrëveshje, Marrëveshja e rishitjes dhe Marrëveshja e aksionarëve do të miratohen nga Kuvendi me anë të një ligji që do të ndikojë këtë miratim dhe ky ligj do të jetë në fuqi dhe me efekt të plotë.

Neni 6.08
Miratimet e qeverisë dhe të tjera

Blerësit do të kenë marrë kopje të noterizuara të të gjitha autorizimeve, miratimeve të kreditorëve, skedimeve dhe regjistrimeve të nevojshme për nënshkrimin, dorëzimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve të projektit nga Shitësi dhe për transaksionet e parashikuara nga kjo Marrëveshje, dokumentet e projektit, vendimet e Këshillit të Ministrave, ligji i nxjerrë nga Kuvendi për miratimin e kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshja e rishitjes dhe Marrëveshja e aksionarëve do të kenë fuqi dhe pasoja të plota.

Neni 6.09
Sigurimet

Shoqëria do të ketë klauzola sigurimi të rregullta apo marrëveshje të pranuar nga blerësit që mbulojnë ekspozimet e klientëve ndaj dëmeve apo humbjeve të tjera biznesi.

Neni 6.10
Emërimet e agjentëve për njoftimet

Palët do të kenë marrë konfirmime të shkruara nga agjentët përkatës për njoftimet gjyqësore, të emëruar nga secili prej IFC dhe Shitësit në përputhje me nenin 7.10 të pranimeve prej tyre të këtyre emërimeve.

Neni 6.11
Mendime ligjore

Blerësit do t'ua kenë marrë të adresuar atyre:

a) mendimin ligjor të Ministrisë së Financave në lidhje me nënshkrimin e rregullt, dorëzimin, sjelljen sipas kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve të projektit, palë e të cilëve janë dhe duke menduar që kjo Marrëveshje dhe dokumentet e tjera të projektit palë e të cilëve ato janë të ligjshme, të vlefshme, të detyrueshme dhe të zbatueshme ndaj Shitësit në përputhje me kushtet e tyre;

b) mendimin ligjor të Ministrit të Drejtësisë që konfirmon mendimin e Ministrisë së Financave i përshkruar në paragrafin (a) më sipër dhe që konfirmon miratimin nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi të shitjes së aksioneve EBRD, EBRD-së dhe aksioneve IFC, IFC-së në përputhje me këtë Marrëveshje;

c) opinione juridike në anglisht të Baker & Botts dhe opinione juridike në shqip nga Boga and Associates në lidhje me klauzolat e kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve të tjera të projektit.

Neni 6.12

Vlefshmëria e vazhdueshme e dokumenteve

Të gjitha marrëveshjet, dokumentet dhe instrumentet e dorëzuara blerësve në zbatim të kreut VI do të jenë të vlefshme dhe përveç Marrëveshjes së rishitjes dhe Marrëveshjes së aksionarëve, në fuqi dhe me efekt të plotë dhe të pakushtëzuar.

Neni 6.13

Deklarime dhe garanci

Deklarimet dhe garancitë e bëra apo konfirmuar nga Shitësi në këtë Marrëveshje do të jenë të vërteta në datën e transferimit dhe si të kësaj date me të njëjtin efekt sikur këto deklaramë dhe garanci të jenë bërë në këtë datë (përveç atyre garancive që referojnë në një datë të caktuar, në të cilën është për t'u vlerësuar).

Neni 6.14

Ndalimi i ndryshimeve të rëndësishme negative

Asgjë nuk do të ketë ndodhur që, në opinionin e arsyeshëm të blerësve, të ketë ndikim të rëndësishëm negativ mbi projektin, biznesin e Shoqërisë, operacionet apo situatën financiare ose aftësinë e shitësit për të kryer ndonjë nga detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6.15

Pezullimi i marrëveshjes EBRD

Bordi drejtues i EBRD-së nuk do të ketë pezulluar aksesin e Republikës së Shqipërisë në burimet e EBRD sipas nenit 8.3 të Marrëveshjes së krijimit të Bankës Europiane për Rindërtim e Zhvillim.

Neni 6.16

Pagesa e tarifave

a) IFC do të ketë marrë nga Ministria e Financave një tarifë vlerësimi në shumën njëqind mijë dollarë (US \$ 100 000) si parashikohet në Marrëveshjen e letrës së mandatit të datës 2 korrik 2003 ndërmjet Ministrisë së Financave dhe IFC-së.

b) EBRD do të ketë marrë nga Ministria e Financave një tarifë vlerësimi në shumën tridhjetë mijë dollarë (US \$ 30 000) siç parashikohet në Marrëveshjen e letrës së mandatit të datës 2 korrik 2003 midis Ministrisë së Financave dhe EBRD-së.

KREU VII TË NDRYSHME

Neni 7.01

Marrëveshja si e tërë, ndryshimi dhe dorëheqja

Kjo Marrëveshje dhe dokumentet të cilat referohen në këtë Marrëveshje përbëjnë gjithë detyrimet e palëve për sa i përket kësaj çështjeje dhe do të bëjë të pavlefshme çdo shprehje të mëparshme të vullnetit apo të kuptuarit në lidhje me këtë transaksion. Çdo ndryshim apo dorëheqje nga ndonjë kusht, rrethanë apo pëlqim i dhënë nga blerësi në bazë të kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë pa kufizim këtë nen) do të jetë me shkrim, e nënshkruar nga blerësit dhe në rast amendimi nënshkruar nga blerësit dhe Shitësi. Shitësi pranon se me hyrjen në këtë Marrëveshje ai nuk është mbështetur në ndonjë përfaqësim, garanci, kontratë paralele apo garanci tjetër e ndryshme nga ato të paraqitura në dokumentet e projektit.

Neni 7.02

Njoftimet

Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim tjetër që bëhet apo i bërë sipas kësaj Marrëveshjeje, për secilën palë, do të jetë me shkrim. Përveç kur Marrëveshja parashikon ndryshe, këto njoftime, kërkesa apo komunikime të tjera do të gjykohen të jenë dhënë rregullisht apo kryer, kur dorëzohen me dorë, postë ajrore ose faks te pala së cilës i kërkohet apo i lejohet të jepet apo kryhet, në adresën e kësaj pale e përcaktuar më poshtë apo në një adresë tjetër që kjo palë cakton duke njoftuar palën që ka dhënë apo ka bërë këtë njoftim kërkesë apo komunikim tjetër.

Për Shitësin:

Ministry of Finance of the Republic of Albania
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tirana
Republic of Albania

Attention: Minister of Finance
Fax: 355 42 28494

Për IFC:

International Finance Corporation
2121 Pennsylvania Avenue, NW
Washington, DC 20433 USA

Attention: Director, Global Financial Market Department
Fax: 202 974 4872
With a copy to: Director, Southern Europe and Central Asia Department
Fax: 202 974 4849

Për EBRD:

European Bank for Reconstruction and
Development
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Attention: Operation Administration Unit
Fax: 44 20 73386100

Neni 7.03

Gjuha angleze

Të gjitha dokumentet e sjella apo komunikimet e dhëna apo të kryera sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen në gjuhën angleze, ose nëse bëhen në ndonjë gjuhë tjetër do të shoqërohen nga përkthimi shqip i noterizuar në prani të Shitësit, përkthim i cili do të jetë versioni kryesor ndërmjet palëve.

Neni 7.04

Llogaritjet financiare

Të gjitha llogaritjet financiare për t'u bërë sipas apo për shkak të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me IAS dhe siç kërkohet ndryshe për të qenë konform dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do të bëhen duke përdorur deklaratat më të reja tremujore financiare të Shoqërisë; duke parashikuar që, nëse deklaratat më të reja financiare të shoqërisë nuk janë audituar, me zgjedhjen e blerësit, për efekt të këtyre llogaritjeve, mund të përdoren raportet e tjera të disponueshme financiare të Shoqërisë.

Neni 7.05

Të drejta, rivendosja e të drejtave dhe dorëheqjet

a) Të drejtat dhe rivendosjet e të drejtave për çdo palë (pala e parë) për çdo keqdeklarim, shkelje deklarimi, garancie, detyrimi, kushti apo rrethane të kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë dokumenti tjetër të projektit nuk do të paragjykohen nga ana e palës tjetër (pala e dytë) nga ndonjë hetim i palës së dytë apo përfaqësuesit të saj në punët e palës së parë apo Shoqërisë, nga lidhja apo

zbatimi i Marrëveshjes apo nga ndonjë akt tjetër apo diçka që mund të jetë bërë nga pala e dytë apo përfaqësues të saj, lidhur me marrëveshjen dhe që mund të paragjykojë këto të drejta apo rivendosje, pavarësisht nga ky nen.

b) Asnjë mënyrë trajtimi apo tërheqjeje nga ndonjë palë apo Shoqëria, në lidhje me ndonjë kusht sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk do të cenojë ndonjë të drejtë, kompetencë apo rivendosje të drejte të kësaj pale në lidhje me ndonjë kusht tjetër dhe as do të interpretohet si dorëheqje nga ky kusht tjetër.

c) Asnjë mënyrë trajtimi ose vonesë në ushtrimin apo mosushtrimin e ndonjë të drejte, kompetence apo rivendosje të drejte që vjen nga ndonjë palë me ndodhjen e ndonjë shkeljeje apo mospërmbylljeje sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohet si dorëheqje prej saj apo pranim aty, nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshje. Asnjë ushtrim i vetëm apo i pjesshëm i kësaj të drejte, kompetence apo rivendosje të drejtë nuk do të përjashtojë ndonjë ushtrim tjetër apo të mëtejshme të kësaj të drejte apo të ndonjë të drejte tjetër, kompetence apo rivendosje të drejte. Asnjë veprim i ndonjë pale në lidhje me këtë shkelje, mospërmbylljeje apo pranim prej saj nuk do të ndikojë apo cenojë ndonjë të drejtë, kompetencë apo rivendosje të drejte të kësaj pale për sa i përket ndonjë shkeljeje apo mospërmbylljeje tjetër.

d) Çdo dorëheqje nga ndonjë palë apo shkelje të ndonjë prej deklarimeve, garancive, detyrimeve, kushteve apo rrethanave në këtë Marrëveshje apo dokument tjetër të projektit ose tjetër lloj lëshimi apo pakujdesie bërë nga kjo palë në çdo kohë do të gjykohej, pa asnjë rezervë të shprehur në këtë drejtim, të jetë e pa paragjykuar dhe nuk do të ndikojë ushtrimin në çdo kohë më pas të të gjitha apo ndonjë prej të drejtave nga kjo palë sipas kësaj Marrëveshjeje si të mos i kish ndodhur tërheqja, lëshimi apo vesi.

e) Të drejtat dhe rivendosjet e të drejtave të parashikuara në këtë Marrëveshje janë kumulative dhe jopërjashtuese të ndonjë të drejte tjetër apo rivendosje të drejte të parashikuar ose jo nga ligji i zbatueshëm.

f) Për të eliminuar dyshimet, blerësit do të ruajnë të gjitha të drejtat dhe rivendosjet e të drejtave të tjera të disponueshme sipas ligjit, përveç kur bihet dakord ndryshe midis blerësve dhe Shitësit me shkrim.

Neni 7.06

Interesi i pagesës së vonuar

Pa paragjykuar rivendosjet e të drejtave të disponueshme për çdo palë sipas kësaj Marrëveshjeje ose jo,

a) nëse ndonjë palë nuk arrin të paguajë në kohën e duhur një shumë të pagueshme prej saj sipas kësaj Marrëveshjeje, shuma e vonuar do të mbartë interes me një normë të barabartë me shumën e:

i) 2.0% në vit;

ii) normën ndërbankare;

b) interesi:

i) do të rrjedhë nga dita në ditë nëpër periudhën e maturimit;

ii) do të llogaritet në numrin real të ditëve të kaluara dhe në vit 360 ditësh;

iii) do të maturohet çdo gjysmëviti;

iv) do të jetë i detyrueshëm dhe i pagueshëm menjëherë pas kërkesës.

Neni 7.07

Tatimet

Asnjë taksë nuk do të vendoset nga ndonjë ent shtetëror mbi fitimet (nëse ka) të realizuara nga EBRD ose IFC, në lidhje me shitjen e ndonjë aksioni të transferuar nga EBRD ose IFC. Asnjë taksë (duke përfshirë taksën e pullës), tatim, tarifë apo detyrim tjetër i pagueshëm në lidhje me nënshkrimin, nxjerrjen, dorëzimin, regjistrimin apo noterizimin e kësaj Marrëveshjeje apo shitjen, transferimin, dorëzimin e ndonjë aksioni të transferuar nga EBRD ose IFC, në zbatim të kësaj

Marrëveshjeje dhe dokumenteve që lidhen me të, nuk do të vendoset nga ndonjë subjekt shtetëror, me kusht që, nëse kjo taksë, tatim tarifë apo detyrim tjetër do të vendosen gjithsesi, kjo shumë do të vendoset dhe paguhet drejtpërdrejt nga Ministria e Financave pa ndonjë pagesë apo rimbursim të kësaj shume nga EBRD apo IFC.

Neni 7.08

Bashkëveprimi

a) Shitësi do të sigurohet që Republika e Shqipërisë do të bëjë përpjekjet më të mëdha për të mos kryer asnjë veprim, nëse objekti apo pasoja të këtij veprimi do të ishin kufizimi apo ndalimi i shitjes, transferimit apo disponimit të ndonjë aksioni nga blerësit dhe, nëse do të jetë e nevojshme Shitësi dhe blerësit do të bashkëveprojnë për të marrë miratimet dhe dorëheqjet e kërkuara për të ndikuar në këto shitje, transferime apo disponim të ndonjë aksioni nga blerësit.

b) Palët bien dakord që, nëse ndonjë dispozitë e statutit, në çdo kohë, bie ndesh me ndonjë klauzolë të kësaj Marrëveshjeje, palët do të ushtrojnë të gjitha kompetencat dhe të drejtat e tyre për të mbështetur amendimin e statutit nga Shoqëria në nivelin e nevojshëm për të lejuar Shoqërinë dhe aktivitetet e saj të rregullohen siç parashikohet në këtë Marrëveshje.

c) Secila nga palët do të zbatojnë të gjitha këto dokumente dhe instrumente të tjera dhe do të bëjë të gjitha këto veprime dhe të tjera, të cilat pala tjetër mund t'i përcaktojë si të nevojshme apo të dëshirueshme për t'i dhënë efekt klauzolave të transferimit në këtë Marrëveshje.

Neni 7.09

Ligji i zbatueshëm

Kjo Marrëveshje do të udhëhiqet dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet e Anglisë dhe Uellsit.

Neni 7.10

Arbitrazhi dhe juridiksioni

a) Çdo mosmarrëveshje, konflikt apo pretendim i ngritur në lidhje me këtë Marrëveshje apo prej saj, shkelje, ndërprerje apo pavlefshmëri po aty do të zgjidhet nga arbitrazhi, në përputhje me rregullat UNCITRAL të arbitrazhit aktualisht në fuqi. Do të ketë një arbitër dhe organi që e emëron do të jetë Gjykata Londineze e Arbitrazhit Ndërkombëtar. Vendi i arbitrazhit do të jetë Londra në Angli dhe gjatë procedimit arbitral do të përdoret gjuha angleze. Palët heqin dorë nga çdo e drejtë sipas aktit të arbitrazhit 1996 apo me fjalë të tjera që të apelojnë vlerësimet e Arbitrazhit, ose të kërkojnë përcaktimin paraprak të së drejtës nga gjykatat e Anglisë. Gjykata e Arbitrazhit nuk do të jetë e autorizuar të marrë apo ofrojë dhe blerësi nuk do të jetë i autorizuar të kërkojë nga ndonjë organ gjyqësor ndonjë masë mbrojtjeje të brendshme apo parashpërbllim ndaj blerësit, jashtë rregullave UNICITRAL të arbitrazhit. Gjykata e Arbitrazhit ka kompetencë të marrë parasysh dhe të përfshijë në çdo procedim, vendim apo shpërbllim, çdo konflikt të sjellë para saj në mënyrën e duhur nga ndonjë prej palëve, nëse ky konflikt lind nga ndonjë dokument projekti, por për sa më sipër, asnjë palë tjetër apo tjetër konflikt nuk do të përfshihet apo bashkohet me procedimin e arbitrazhit.

b) Pavarësisht nga paragrafi 7.10 (a), kjo Marrëveshje, dokumentet e projektit dhe të drejtat e blerësit që lindin prej apo në lidhje me këtë Marrëveshje apo ndonjë dokument projekti, mund të zbatohen nga blerësit në gjykatat e Republikës së Shqipërisë apo në ndonjë gjykatë tjetër që ka juridiksion, sipas zgjedhjes së blerësit. Në dobi të blerësve, Shitësi i nënshtrohet në mënyrë të parevokueshme juridiksionit joekskluziv të gjykatave të Anglisë dhe të Republikës së Shqipërisë në lidhje me ndonjë konflikt, mosmarrëveshje apo pretendim që lind sipas kësaj Marrëveshjeje apo dokumenteve të projektit apo në lidhje me këto ose shkelje, ndërprerje apo pavlefshmëri të tyre këtu apo aty. Shitësi dhe IFC, secili në mënyrë të parevokueshme caktojnë, emërojnë dhe i japin fuqi personit të treguar në nenin 7.17 që të veprojnë si agent i autorizuar i tij për të përfituar njoftimet gjyqësore dhe çdo thirrje tjetër ligjore në Angli, për qëllim të ndonjë padie apo procedimi të ngritur

nga blerësit sipas kësaj Marrëveshjeje. Shitësi në mënyrë të parevokueshme pranon thirrjen për proces apo ndonjë thirrje tjetër ligjore në këto gjykata me kopje të postuara prej aty me postë ajrore të regjistruar, të parapaguar në adresën e tij të treguar këtu. Shitësi premton dhe bie dakord që derisa të ketë detyrime sipas kësaj Marrëveshjeje, ai do të mbajë një agjent të emëruar në mënyrë të rregullt për përfitimin e njoftimeve dhe ndonjë thirrje tjetër ligjore në Angli për qëllim të ndonjë padie apo procedimi të ngritur nga blerësi sipas kësaj Marrëveshjeje dhe do të njoftojë blerësin mbi identitetin dhe vendndodhjen e këtij agjenti. Asgjë këtu nuk do të prekë të drejtat e blerësve për të filluar padi apo procedime kundër Shitësit në çdo mënyrë të autorizuar nga ligjet e juridiksionit përkatës. Ngritja nga blerësit e padive apo fillimi i procedimeve në një apo më tepër juridiksione nuk do t'i përjashtojë blerësit nga e drejta për të filluar procedime apo padi në një juridiksion tjetër, njëkohësisht ose jo. Shitësi heq dorë pa revokim nga çdo objeksion që mund të ketë tani apo më pas, me çfarëdo lloj arsye për sa i përket vendit të ngritjes së padisë apo procedimit dhe çfarëdo lloj pretendimi që ai mund të ketë tani apo më pas për ndojë padi apo procedim të ngritur apo të filluar në një forum të papërshtatshëm.

Neni 7.11

Privilegjet dhe imunitetet e EBRD-së dhe IFC-së

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të interpretohet si tërheqje, mohim apo modifikim i ndonjë imuniteti, privilegji apo përjashtimi të EBRD-së akorduar sipas Marrëveshjes për krijimin e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, konvente ndërkombëtare apo ndojë tjetër të drejte në zbatim dhe e IFC-së sipas kapitujve të saj të Marrëveshjes, konventës ndërkombëtare apo ndonjë të drejte në zbatim.

Neni 7.12

Heqja dorë nga imuniteti

Shitësi (në nivelin më të plotë të lejuar nga ligji i zbatueshëm) në mënyrë të pakthyeshme dhe pa kushte:

a) pranon që nënshkrimi, dorëzimi dhe zbatimi prej tij i kësaj Marrëveshjeje përbën veprim privat dhe komercial;

b) heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti që ka ai apo aktivet e tij, apo që mund të fitojë pas datës së kësaj Marrëveshjeje në lidhje me ndonjë procedim juridik, të ngritur kundër tij apo aktiveve të tij në lidhje me këtë Marrëveshjeje nga blerësit ose Shoqëria dhe/ose përfaqësuesit përkatës;

c) pranon që asnjë imunitet nga këto procedime (që do të konsiderohet se përfshijnë, pa përjashtim, padi, sekuestro para procedimit, sekuestro të tjera, marrjen e vendimit, ekzekutimin apo zbatim tjetër) nuk do të pretendohet prej tij, në emër të tij apo në lidhje me aktivet e tij;

d) pranon përgjithësisht, për sa i përket këtyre procedimeve, bërjen e ndonjë lehtësime ose lajmërimeve për procesin në lidhje me ato procedime, duke përfshirë pa kufizim bërjen, zbatimin apo ekzekutimin ndaj ndonjë prone të çfarëdoshme (pa iu referuar përdorimit apo qëllimit të përdorimit të saj) të ndonjë urdhri apo vendimi që mund të jetë dhënë në këto procedime.

Neni 7.13

Pasardhësit dhe të caktuarit

Asnjë palë nuk do të ketë të drejtë të japë apo të transferojë të drejtat dhe detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje pa miratimin paraprak me shkrim të palëve, përveç kalimit apo transferimit të një personi që zotëron aksione në përputhje me një dokument projekti.

Neni 7.14
Dhënie informacioni

Secila palë mund të bëjë të njohur çdo dokument, informacion dhe të dhënë në lidhje me ndonjë palë tjetër dhe transaksion (duke përfshirë, pa kufizim, kopje të ndonjë dokumenti) që pala që e bën e gjykon të përshtatshme në lidhje me ndonjë konflikt që përfshin këtë Marrëveshje apo dokumentet e projektit me qëllim ruajtjen apo zbatimin e ndonjë të drejte të palës zbuluese sipas kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë dokumenti të projektit.

Neni 7.15
Kopjet

Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet në disa kopje, secila prej të cilave do të konsiderohet origjinale, por të gjitha së bashku do të përbëjnë një dhe të njëjtën Marrëveshje.

Neni 7.16
Veçueshmëria

Dispozitat e çdo neni dhe paragrafi të kësaj Marrëveshjeje do të jenë të zbatueshme në mënyrë të pavarur nga të tjerët dhe vlefshmëria e tyre nuk do të preket nëse ndonjë prej të tjerëve është i pavlefshëm. Nëse ndonjë nga këto dispozita është e pavlefshme, por do të ishte e vlefshme nëse disa pjesë të dispozitës do të fshiheshin, dispozita në fjalë do të zbatohet me modifikimet e nevojshme për ta bërë të vlefshme.

Neni 7.17
Agjentët e autorizuar për njoftime

Për shitësin: The Embassy of the Republic of
Albania
2nd Floor
24 Buckingham Gate
London SW 1 E6LB
England

Për IFC: International Finance Corporation
4 Millbank
London SW 1P 3JA
England

Neni 7.18
Të drejtat e palëve të treta

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk ka për qëllim t'i japë ndonjë të drejtë asnjë personi që nuk është palë dhe Contract Act 1999 (Të drejtat e të tretëve) nuk do të zbatohet në këtë Marrëveshje.

Në prani të dëshmitarëve, palët nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë bërë të mundur nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje në emrat e tyre përkatës, në datën e shkruar për herë të parë më sipër,

Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë

Nga: _____

Emri:

Titulli: Ministër i Financave të Republikës së Shqipërisë

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim

Nga: _____

Emri:

Titulli: President, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim

KORPORATA FINANCIARE NDËRKOMBËTARE

Nga:

Emri: Peter L.Woicke

Titulli: Zëvendëspresident Ekzekutiv, Korporata Financiare Ndërkombëtar

SHTOJCA A- DEKLARATA E POLITIKËS OPERATIVE

SHTOJCA B-1 - FORMA E LETRËS PËR EKSPERTËT KONTABËL
(Të vihet koka e letërkëmbimit të Shoqërisë)

Data

Emri i ekspertëve kontabël

Adresa

Zoti/Zonja

Nëpërmjet kësaj letre ju autorizojmë dhe kërkojmë që ju t'i jepni Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) të gjithë informacionin që ndonjë prej tyre mund ta kërkojë, në mënyrë të arsyeshme, për sa i përket deklaratave tona financiare të audituara dhe ato të paaudituar.

Ne ju autorizojmë juve t'ia dërgoni EBRD-së dhe IFC-së llogaritë tona të audituara. Ju kërkojmë gjithashtu që, së bashku me këto llogari të audituara, të dërgoni në të njëjtën kohë një kopje të raportit tuaj të plotë mbi këto llogari në një formë të pranueshme për EBRD-në dhe IFC-në.

Për dokumentim, ju lutemi të na dërgoni dhe ne një kopje të çdo letre që ju merrni nga IFC dhe EBRD me mbërritjen e saj dhe një kopje të çdo përgjigjeje tuaj menjëherë pasi ta ktheni.

I juaji sinqerisht

Instituti i Sigurimeve sh.a.

Nga : _____
Nënshkrues i autorizuar

Cc: European Bank for Reconstruction and Development
One exchange Square
London EC2A 2JN, United Kingdom
Attention: Operation Administratin Unit
Subject: Operation No.28277

Cc: International Finance Corporation

International Fianance Corporation
2121 Pennsylvania Avenue, NW
Washington, DC 20433 USA
Attention: Director, Global Fianancial Market Departament
Director, Southerm Europe and Central Asia Department
Subject: Investment No.11286

SHTOJCA B-2 - FORMA E LETRËS PËR RREGULLATORIN E SIGURIMEVE

Të vihet koka e letërkëmbimit të Shoqërisë

Data

Emri i organit rregullator të sigurimeve

Adresa

Zoti/Zonja:

Në përputhje me kushtet e Marrëveshjes për blerjen e aksioneve datë (_____) (Marrëveshja për blerjen e aksioneve) ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC), ne ju autorizojmë dhe kërkojmë që t'ua jepni EBRD-sp dhe IFC-së të gjithë informacionin që ndonjë prej tyre mund të kërkojë, në mënyrë të arsyeshme, në lidhje me ligjet dhe rregulloret për sigurimet në zbatim në Republikën e Shqipërisë.

Ne kërkojmë që ju të na dërgoni për dokumentacionin tonë një kopje të çdo letre që ju merrni prej EBRD dhe IFC menjëherë pas mbërritjes dhe një kopje të çdo përgjigjeje tuaj menjëherë pasi e dërgoni.

I juaji sinqerisht.

Instituti i Sigurimeve sh.a.

Nga:

Nënshkrues i autorizuar

Cc: European Bank for Reconstruction and Development
One Exchange Square
London EC2A 2JN, United Kingdom
Attention: Operation Administratin Unit
Subject: Operation No.28277

Cc: International Finance Corporation

International Finance Corporation
2121 Pennsylvania Avenue, NW
Washington, DC 20433 USA
Attention: Director, Global Financial Market Departament
Director, Sothern Europe and Central Asia Department
Subject: Investment No.11286

SHTOJCA C- FORMË KËRKESE PËR PAGESË DHE NËNSHKRIM

Datë

International Finance Corporation

2121 Pennsylvania Avenue, NW

Washington, DC 20433 USA

Attention: Director, Global Financial Market Department

Director, Southern Europe and Central Asia Department

European Bank for reconstruction and Development

One Exchange Square

London EC2A 2JN, United Kingdom

Attention: Operation Administration Unit

Zonja dhe Zotërinj:

Kërkesë për pagesë

Investimi IFC nr.11286/Investimi EBRD nr.28277

1. Ju lutemi referohuni Marrëveshjes së blerjes së aksioneve (Marrëveshja e blerjes së aksioneve) e datës () 2003 ndërmjet Ministrisë së Financave, që vepron në emër të shtetit shqiptar (Shitësi) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), si dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC). Kushtet e Marrëveshjes së blerjes së aksioneve i kanë kuptimet e tyre të përcaktuara sa herë që përdoren në këtë kërkesë.

2. Në vijim të dispozitave të nenit 3.03 (a) të Marrëveshjes së blerjes së aksioneve, Shitësi në këtë mënyrë kërkon pagimin nga secili prej blerësve të çmimit fillestar të blerjes në lidhje me aksionet e IFC-së dhe EBRD-së më () 2003 (Data e transferimit). Secilit prej blerësve i kërkohet të paguajë këtë shumë në llogarinë e Shitësit në (emri i bankës: vendndodhja e bankës), numër llogarie () kundrejt një fature të blerësit në këtë datë të pjesëve të shkëputura të nxjerra nga qendra e regjistrimit të aksioneve sikurse parashikohet në nenin 3.03 (b) të Marrëveshjes së blerjes së aksioneve.

3. Lutemi vini re detajet e mëposhtme:

Monedha e kërkuar: dollarë amerikanë

Sasia (në shifra dhe fjalë: _____)

Data e vlerësimit: data e transferimit

Udhëzimet e pagesës (të dhënat bankare të Shitësit):

Emri i llogarisë: _____

Numri i llogarisë: _____

Emri i bankës: _____

Adresa e bankës: _____

Të dhënat korrespondente të Bankës së Shitësit

Emri i korrespondentit: _____

Adresa e korrespondentit: _____

Emri i llogarisë: _____

Numri i llogarisë: _____

4. Shitësi nëpërmjet kësaj vërteton se:

a) Autorizimet janë të ligjshme në datën e kësaj kërkesë dhe do të jenë të tilla edhe në datën e transferimit me të njëjtën forcë si të ishin bërë në atë datë (ndryshe nga ato autorizime që i referohen një date specifike në të cilën gjykohet saktësia e tyre).

b) Në opinionin e Shitësit nuk ka ndodhur asgjë që mund të ketë një ndikim negativ në projekt, në biznesin e Shoqërisë, në aktivitetin ose kushtet financiare ose në aftësinë e Shitësit për të përmbushur ndonjë nga detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së blerjes së aksioneve.

4. Sikurse është rënë dakord midis Shitësit dhe blerësit, nëse për ndonjë arsye kushtet e nenit 3.03 të Marrëveshjes së blerjes së aksioneve nuk përmbushen në datën e transferimit të specifikuar në këtë dokument, Shitësi dhe blerësi së bashku do të caktojnë një datë të re për transferimin e aksioneve IFC dhe EBRD, e cila nuk duhet të jetë më vonë se 3 janar 2004 dhe që do të gjykohet si datë e transferimit.

L I G J

Nr.9177, datë 29.1.2004

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË AKSIONARËVE, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE, QË VEPRON NË EMËR TË SHETIT SHQIPTAR, INSIG SHA-SË, KORPORATËS FINANCIARE NDËRKOMBËTARE (IFC) DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (BERZH)"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e aksionarëve, ndërmjet Ministrisë së Financave, që vepron në emër të shtetit shqiptar, INSIG Sha-së, Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4136, datë 20.2.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

AKSIONARËSH NDËRMJET BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM DHE KORPORATËS NDËRKOMBËTARE FINANCIARE DHE MINISTRISË SË FINANCAVE, QË VEPRON NË EMËR TË SHTETIT SHQIPTAR DHE INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHA

Marrëveshja e aksionarëve

Marrëveshje, në datë _____ ndërmjet Ministrisë së Financave, që vepron në emër të shtetit Shqiptar, në bazë të ligjit nr.8831, datë 22 nëntor 2001, në pronësi të shtetit, të shoqërive tregtare financiare me kapital shtetëror të plotë aksionarësh, zotërues i aksioneve të Institutit të Sigurimeve sh.a., përfaqësuar nga Ministri i Financës (MIF), Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) dhe Institutit të Sigurimeve sh.a. (Shoqëria).

Duke pasur parasysh që:

A) MIF zotëron të gjitha aksionet e zakonshme me të drejtë vote të emetuara dhe të pashlyera të Shoqërisë, shoqëria anonime organizohet, funksionon dhe është e licencuar si një shoqëri sigurimesh sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë;

B) Në vijim të një marrëveshjeje për blerje aksionesh, në të njëjtën ditë si këtu, nga dhe ndërmjet MIF, EBRD dhe IFC (Marrëveshja për blerjen e aksioneve), aksionarët kanë rënë dakord që MIF do t'ia shesë aksionet e EBRD EBRD-së dhe aksionet e IFC IFC-së;

C) Kjo Marrëveshje përcakton disa të drejta dhe detyrime të aksionarëve lidhur me organizimin dhe administrimin e Shoqërisë dhe mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë, të gjitha në mbështetje të projektit siç përcaktohet këtu;

prandaj, aksionarët bien dakord sa më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

Paragrafi 1.01 Përkufizime

Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje, përveç rastit kur janë përkufizuar ndryshe këtu ose përveç rastit kur konteksti i kërkon ndryshe, termat e përkufizuara, në Marrëveshjen për shitjen e aksioneve do të kenë të njëjtin kuptim edhe në këtë Marrëveshje dhe termat e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

“Njoftimi i pranimit” përkufizohet në paragrafin 6.06 (e).

“Kosto e përbërë” është kostoja e blerjes IFI të çdo aksionari IFI në dollarë, plus interesin e barabartë me shumën e përqindjes së Interbank (për çdo periudhë të llogaritjes), plus tre për qind në vit nga data e duke përfshirë datën e transferimit, por duke përjashtuar datën kur çmimi *drag-along* është paguar, një interes i tillë llogaritet mbi bazën e numrit aktual të ditëve që kanë kaluar dhe të një viti prej 360 ditësh dhe i llogaritur në fund të çdo periudhe të përbërë.

“Data e përbërë” është:

i) në lidhje me çdo aksion të EBRD ose IFC që do të transferohet sipas nenit 6.05:

a) data e transferimit;

b) data e gjashtë muajve pas kësaj date;

c) çdo përvjetor i datave në pikat (a) dhe (b);

me kusht që, nëse një datë e tillë nuk është ditë-pune, atëherë data e përbërë do të jetë dita e parë e punës që vijon.

“Dividendët e përbërë” janë shuma në dollarë e marrë nga çdo aksionar në fonde menjëherë të disponueshme si shuma të hollash të paguara për ose në lidhje me aksionet përkatëse të aksionarëve të IFI përpara datës së pagesës së çmimit *drag-along*, plus interesin e barabartë me shumën e përqindjes së Interbank (për çdo periudhë të llogaritjes) nga data ose datat e pagesës nga aksionari i duhur IFI e duke përjashtuar datën kur është paguar *drag-along*, një interes i tillë llogaritet mbi bazën e numrit aktual të ditëve të kaluara dhe të një viti prej 360 ditësh dhe llogaritet në fund të çdo periudhe të përbërë.

“Periudha e përbërë” është çdo periudhë gjashtëmujore, që fillon dhe përfshin datën e përbërë, përveç periudhës së fundit të përbërë, që përfshin këtë periudhë, por përjashton datën e pagesës së çmimit *drag-along*.

“Primi” është çmimi për aksion i barabartë me shumën *drag-along* në dollarë të përfituar nga zbritja e dividendëve të përbërë nga kosto e përbërë dhe duke e ndarë totalin me numrin e aksioneve të EBRD dhe IFC, të blera nga aksionari i duhur i IFI-së në përputhje me Marrëveshjen për blerjen e aksioneve.

“Çmimi *drag-along*” shuma më e madhe:

a) e ekuivalentit në dollarë: (i) të vlerës për aksion që i është paguar MIF nga investitori strategjik (dhe nëse kjo vlerë nuk është në lekë, ekuivalentin në lekë të kësaj vlere); (ii) shumëzuar me numrin e aksioneve të EBRD-së dhe aksioneve të IFC, sipas rastit; me një shumë ekuivalente në dollarë, që do të përcaktohet në bazë të kursit zyrtar të këmbimit nga dollari në lekë, që publikohet nga Banka e Shqipërisë dy (2) ditë-pune përpara ditës në të cilën është paguar kjo shumë;

b) e primit *drag-along* sipas rastit.

“Mbledhja e përgjithshme” është çdo mbledhje e përgjithshme vjetore ose e jashtëzakonshme e aksionarëve të Shoqërisë.

“Kostoja e blerjes nga IFI” është shuma e çmimit fillestar të blerjes në dollarë të përshtatur në bazë të Marrëveshjes së blerjes së aksioneve, të paguar nga aksionari përkatës i IFI, me qëllim pagesën për aksionet e IFI të blera nga ai së bashku me (objekt i një shume maksimale prej pesëdhjetë USD) ndonjë kosto transaksioni të paguar nga aksionari përkatës i IFI në lidhje me këtë blerje, që nuk është rimbursuar sipas mënyrës së pagesës, të përshkruar në paragrafin 6.16 të Marrëveshjes së blerjes së aksioneve.

“Aksionarët e IFI” janë EBRD dhe IFC (nëse të dyja janë në kohën e duhur aksionare të Shoqërisë) ose edhe EBRD ose IFC (në rastin kur vetëm njëra është aksionare e Shoqërisë në kohën e duhur).

“Aksionet e IFI” janë aksionet e EBRD dhe aksionet e IFC.

“Bordi drejtues” janë menaxherët e Shoqërisë, që kanë përgjegjësi për aktivitetin e përditshëm dhe operacionet e Shoqërisë.

“Anëtar” është anëtar i këshillit mbikëqyrës.

“Aksione të MIF” është kapitali i aksioneve të zakonshme me të drejtë vote, që zotërohen nga MIF ose ndonjë person i autorizuar prej saj.

“Vlera neto e aseteve” është vlera e të gjitha aseteve të Shoqërisë, duke zbritur të gjitha detyrimet e Shoqërisë, siç tregohet në pasqyrën financiare të audituar më të fundit.

“Njoftim” është, siç e kërkon konteksti, njoftimi i rishitjes (siç përkufizohet në Marrëveshjen e rishitjes), njoftimi i transferimit dhe çdo njoftim i bërë në bazë të paragrafit 6.04 ose 6.05.

“Ofertë” përkufizohet në paragrafin 6.06(c).

“Shitës i propozuar” përkufizohet në paragrafin 6.04.

“Transferimi i propozuar” përkufizohet në paragrafin 6.04.

“Rast rishitjeje” ka kuptimin që i është dhënë në Marrëveshjen e rishitjes.

“Marrës” përkufizohet në paragrafin 6.06(a).

“Aksionarët” janë aksionarët e MIF dhe IFI.

“Marrëveshje për blerje aksionesh” është ajo që përkufizohet në pjesën hyrëse (germa B).

“Njoftimi *tag-along*” përkufizohet në paragrafin 6.04.

“Çmimi i transferimit” përkufizohet në paragrafin 6.06(b).

“Njoftimi i transferimit” përkufizohet në paragrafin 6.06(a).

“Aksionet e transferimit” përkufizohet në paragrafin 6.06(b).

“Transferues” përkufizohet në paragrafin 6.06(a).

Paragrafi 1.02 Interpretimi

a) Në këtë Marrëveshje, përveç kur kërkohet ndryshe në kontekst, fjalët që paraqiten në njëjës përfshijnë shumësin dhe anasjelltas.

b) Në këtë Marrëveshje, përveç rastit kur duket që ka synim të kundërt, kur i referohet:

i) "Kontrollit" (duke përfshirë, me kuptimet korelative, termat "kontrolluar nga" dhe "nën kontrollin e përbashkët me"), kur përdoret në lidhje me ndonjë person, do të thotë zotërim, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose jo, i kompetencës për të drejtuar ose për të shkaktuar drejtimin e menaxhimit dhe politikave të këtij personi, qoftë nëpërmjet zotërimit të aksioneve me të drejtë vote, interesit në pronësi, kontratës ose ndonjë forme tjetër.

ii) "Një muaj" i referohet një periudhe që fillon në një ditë të një muaji kalendarik dhe përfundon në ditën që korrespondon numerikisht në muajin pasardhës kalendarik, përveç rastit kur nuk ka ditë korresponduese numerike në muajin kur mbaron periudha. Kjo periudhë do të përfundojë në ditën e fundit të atij muaji kalendarik, ____.

iii) "Person" përfshin çdo individ, person juridik, firmë shoqëri, ortakëri, subjekt shtetëror, shoqëri të përbashkët, së bashku me pasardhësit dhe personat e autorizuar të këtij personi.

iv) "Rregullore" përfshin çdo direktivë të çdo subjekti shtetëror.

v) Kjo Marrëveshje apo ndonjë dokument, kontratë ose marrëveshje tjetër përfshin referencën që i bëhet çdo ndryshimi ose shtesë të lejuar në këtë Marrëveshje dhe një dokument i tillë, kontratë ose marrëveshje e ndryshuar ose e shtuar herë pas here, por duke lënë mënjane çdo ndryshim, shtesë, zëvendësim ose novacion që është bërë në kundërshtim me këtë Marrëveshje.

vi) Marrëveshja i referohet kësaj Marrëveshjeje, së bashku me pjesët hyrëse dhe pasqyrat e saj.

vii) Çdo ligj, dekret ose dispozitë ligjore përfshin çdo ligj, dekret ose dispozitë ligjore, të cilat e ndryshojnë apo zëvendësojnë ose e kanë ndryshuar apo zëvendësuar atë dhe përfshin çdo legjislacion nënrenditës (duke përfshirë, por pa ndonjë kufizim, çdo udhëzim ose vendim të subjektit shtetëror) të dalë nga ky ligj, dekret apo dispozitë ligjore.

viii) Një pjesë hyrëse e caktuar, nen, paragraf ose pasqyrë do të interpretohet si referencë ndaj asaj pjese hyrëse, neni, paragrafi ose pasqyre të kësaj Marrëveshjeje.

ix) Titujt dhe pasqyra e përmbajtjes janë vendosur vetëm për lehtësi referimi dhe nuk kanë ndikim në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.

x) Një dokument që është i "një forme të rënë dakord" nënkupton formën e një dokumenti të tillë të miratuar paraprakisht nga palët.

Neni 2

Kushtet paraprake

Paragrafi 2.01 Fillimi, efektiviteti

a) Kjo Marrëveshje hyn në fuqi datën e transferimit.

b) Detyrimet e MIF në këtë Marrëveshje janë të kushtëzuara nga blerja e EBRD-së të aksioneve të EBRD dhe nga blerja e IFC të aksioneve të IFC në përputhje me Marrëveshjen e blerjes së aksioneve.

Neni 3

Mbledhja në datën e mbylljes

Paragrafi 3.01 Vendimet e Shoqërisë

Aksionarët do të organizojnë një mbledhje të përgjithshme aksionarësh dhe një mbledhje të këshillit mbikëqyrës, që duhet të mbahen në datën e transferimit, në të cilat do t'i jepet zgjidhje çështjeve të mëposhtme:

a) Emërimi i këshillit mbikëqyrës me votë unanime të mbledhjes së përgjithshme që përbëhet nga gjashtë (6) anëtarë, duke përfshirë nga një (1) anëtar të emëruar nga EBRD dhe IFC, tre (3) anëtarë të emëruar nga MIF dhe një (1) anëtar në përputhje me procedurat e parashikuara në paragrafin 5.03; me kusht që këshilli mbikëqyrës të mos përfshijë asnjë anëtar të këshillit drejtues apo nëpunës të tjerë të lartë të Shoqërisë; si dhe së paku një nga anëtarët e caktuar nga aksionarët e IFI të jetë person me përvojë pune të mirë në fushën e sigurimeve.

b) Zgjedhja me shumicë votash e të gjithë anëtarëve të këshillit mbikëqyrës (me kusht që njëra prej votave në favor të çdo emërimi të jetë ajo e njërit prej anëtarëve të caktuar nga aksionarët e IFI), të një komiteti kontrolli, i cili përfshin një anëtar të caktuar nga MIF, një komitet shpërblimi, i cili duhet të përfshijë një anëtar të emëruar nga MIF dhe një komitet investimesh, i cili do të kryesohet nga një anëtar i caktuar nga EBRD ose IFC dhe do të përfshijë një anëtar të caktuar nga MIF.

c) Emërimi i kryetarit të këshillit mbikëqyrës në përputhje me paragrafin 5.02(d).

d) Në varësi të paragrafit 4.01(i), caktimi i një shoqërie të njohur ndërkombëtare kontabiliteti si kontrolore ndërkombëtare e Shoqërisë.

e) Emërimi i ekspertëve kontabël shqiptarë të miratuar.

f) Miratimi i deklaratës për rregullat e funksionimit, pasqyra A bashkëngjitur.

g) Miratimi i ndryshimeve të statutit në formën e rënë dakord.

h) Çdo vendim tjetër të nevojshëm për të bërë efikase dispozitat e çdo dokumentprojekti ose që është i nevojshëm për zhvillimin e projektit.

Neni 4

Veprimtaria e Shoqërisë dhe drejtimi i saj

Paragrafi 4.01 Zotime pozitive

Çdo aksionar do të ushtrojë të drejtat e tij si aksionar, të cilat krijojnë detyrime për Shoqërinë, dhe Shoqëria:

a) do të zbatojë projektin;

b) do të kryejë veprimtarinë e saj me efikasitet, drejtësi dhe në përputhje me deklaratën për rregullat e funksionimit;

c) do të kryejë veprimtarinë duke pasur kujdesin e duhur ndaj mjedisit dhe publikut, shëndetit e sigurisë dhe në përputhje me direktivat e mjedisit dhe rregulloret e standardet e mjedisit që janë në fuqi në çdo kohë në Republikën e Shqipërisë;

d) do të bëjë përpjekjet e saj më të forta për ta mbajtur të paprekur organizimin e veprimtarisë së saj, për të mbajtur në dispozicion nëpunësit e pranishëm, agjentët dhe të punësuarit (në përputhje me dispozitat e dokumentit të projektit) dhe t'u ruajë emrin e mirë të gjithë klientëve, risiguruesve, furnizuesve dhe të tjerëve që kanë lidhje biznesi me të;

e) për të pasur në rregull dhe për të ruajtur në çdo kohë risigurim të përshtatshëm, të pranueshëm për aksionarët e IFI që mbulojnë ekspozimin e klientëve nga rreziqet ose humbje të tjera biznesi;

f) do të lejojë aksionarët dhe përfaqësuesit e tyre të autorizuar që të kenë të drejtën e plotë për të hyrë në të gjitha pronat e saj, asetet, regjistrimet, kthimet e taksave, kontratat e dokumentet dhe të pajisë aksionarët ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar me dokumente financiare dhe ndonjë informacion tjetër lidhur me veprimtarinë ose asetet e saj, siç mund të kërkoher herë pas here, në mënyrë të arsyeshme nga aksionarët;

g) do të krijojë dhe do të ruajë procedurat e brendshme, të pranueshme për aksionarët e IFI, me qëllim moslejimin e Shoqërisë për t'u bërë një instrument i pastrimit të parave, mashtrimit apo për qëllime të tjera korruptuese ose të jashtëligjshme (Politika kundër pastrimit të parave);

h) do të mbajë një sistem llogarie dhe kontrolli, sistem të menaxhimit të informacionit dhe librat e llogarisë, si edhe të dhëna të tjera, të cilat së bashku reflektojnë realisht dhe drejt gjendjen financiare të Shoqërisë dhe rezultatet e veprimeve të saj në përputhje me IAS; duke filluar që nga 1 korriku 2004, këto sisteme, libra dhe të dhëna do të mbahen në përputhje me IAS;

i) do të mbajë kontrollorë të pavarur, të pranueshëm për aksionarët e IFI dhe do t'i autorizojë ata të komunikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë me aksionarët e IFI sipas kushteve të përcaktuara në pasqyrën B1 të Marrëveshjes së blerjes së aksioneve;

j) do të sigurojë dhe do të mbajë në fuqi të gjitha autorizimet e nevojshme;

k) do të jetë në përputhje me ligjin e zbatueshëm, duke përfshirë të gjitha ligjet e sigurimit dhe kërkesat rregullatore të parashkruara nga komisioni i mbikëqyrjes së sigurimeve, sipas kushteve të përcaktuara në pasqyrën B2 të Marrëveshjes së blerjes së aksioneve dhe do të autorizojë

aksionarët e IFI që të komunikojnë drejtpërdrejt, në çdo kohë, me komisionin e mbikëqyrjes së sigurimeve për përputhjen e Shoqërisë me këto ligje dhe rregullore për sigurimin dhe për çdo çështje tjetër;

l) do të jetë në përputhje me statutin;

m) do t'i mbajë aksionet në formë të regjistruar (jo për prurësin) gjatë gjithë kohës;

n) do të caktojë dhe mbajë një agjent njoftimesh në Angli dhe

o) do të jetë në përputhje me kërkesat e mëposhtme të raportimit:

i) Brenda 90 ditëve nga fundi i çdo viti financiar (përveç vitit financiar që përfundon më 31 dhjetor 2003, për të cilin kjo periudhë do të jetë 120 ditë), auditorët duhet t'i dërgojnë aksionarëve: (1) pasqyra financiare të kontrolluara e të bashkuara vjetore të përgatitura në përputhje me IAS, përfshirë bilancin, fitimin dhe llogaritë e humbura, deklaratimet e qarkullimit të të hollave, së bashku me shënimet e llogarive financiare; (2) një certifikatë të këshillit mbikëqyrës, të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e këshillit mbikëqyrës, që deklaron se në bazë të njohurive të këshillit mbikëqyrës, nuk ka pasur shkelje të ndonjë prej detyrimeve të parashikuara në paragrafin 3.01 ose, nëse ka pasur shkelje, detajet e kësaj shkeljeje; (3) një letër nga kontrollorët drejtuar këshillit mbikëqyrës, që konfirmon përshtatshmërinë e procedurave të kontrollit financiar të Shoqërisë dhe sistemeve të llogarisë ose që ata nuk janë në gjendje ta konfirmojnë këtë përshtatshmëri, detajet e papërshtatshmërive përkatëse, si dhe çështje të tjera që mendohen si të përshtatshme nga aksionarët; (4) një deklaratë të transaksioneve financiare me palët e afërta (aksionarët, nëpunësit, punonjësit); (5) një raport në përputhje me direktivat financiare dhe raportet financiare të parashikuara në deklaratën për rregullat e funksionimit; dhe (6) një raport mbi çdo transaksion që nuk përfshihet në rrjedhën e përditshme të biznesit dhe statusin e çdo investimi të pasurisë së paluajtshme;

(ii) Brenda 90 ditëve nga fundi i çerekut të dytë dhe të katërt të çdo viti financiar (përveç çerekut të katërt të vitit financiar që përfundon më 31 dhjetor 2003, për të cilin kjo periudhë do të jetë 120 ditë), t'i pajisë aksionarët e IFI me një raport të drejtimit të Shoqërisë lidhur me: (1) investimet afatshkurtra dhe afatgjata të Shoqërisë dhe (2) llogaritjet teknike rezervë të Shoqërisë;

iii) Brenda 90 ditëve nga fundi i çdo viti financiar (përveç vitit financiar që përfundon më 31 dhjetor 2003, për të cilin kjo periudhë do të jetë 120 ditë), t'i pajisë aksionarët e IFI me një raport të detajuar që konfirmon se Shoqëria i ka marrë masat, të pranueshme për aksionarët e IFI, që mbulojnë pronat dhe biznesin e Shoqërisë kundrejt humbjes, dëmtimit dhe/ose mashtrimit dhe, ndër të tjera, masa risigurimi të mjaftueshme, të pranueshme nga aksionarët e IFI, që mbulojnë ekspozimin e klientit ose humbje të tjera biznesi;

iv) Brenda 90 ditëve nga fundi i çdo viti financiar, t'i pajisë aksionarët me një raport mbi çështjet thelbësore të mjedisit që janë ngritur në lidhje me veprimtarinë e Shoqërisë. Ky raport të përfshijë një skicë të shkurtër mbi dosjen e investimit të Shoqërisë, përfshirë pasurinë e paluajtshme, një përmbledhje të çështjeve të rëndësishme të mjedisit, shoqëruar me dosjen e investimit të Shoqërisë, dhe nëse Shoqëria ose klientët e korporatës së saj më të madhe janë subjekt i ndonjë pretendimi apo hetimi mbi mjedisin (Raporti vjetor mbi mjedisin);

v) Brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori financiar të vitit financiar (përveç tremujorëve të vitit financiar që mbyllet më 31 dhjetor 2003, për të cilin kjo periudhë do të jetë 45 ditë), t'i pajisë aksionarët me: (1) pasqyra financiare të konsoliduara të pakontrolluara tremujore të përgatitura në përputhje me IAS (përveç tremujorëve financiarë gjatë vitit financiar që përfundon më 31 dhjetor 2003, për të cilin pasqyrat financiare të pakontrolluara mund të përgatiten në përputhje me parimet shqiptare të kontabilitetit që zbatohen vazhdimisht); (2) një raport të investimeve afatshkurtra dhe afatgjata të Shoqërisë; (3) një raport mbi llogaritjet e rezervës teknike; dhe (4) një raport në përputhje me direktivat financiare dhe raportet financiare të parashikuara në deklaratën për rregullat e funksionimit;

vi) Brenda 30 ditëve pas marrjes nga Shoqëria dhe pas përkthimit të tij në anglisht, t'i pajisë aksionarët me një kopje të raportit për mbikëqyrjen e përputhjes (nëse ka), hartuar nga komisioni i mbikëqyrjes së sigurimeve lidhur me veprimet e Shoqërisë dhe ndonjë njoftim mospërputhjeje ose raporte vërejtjeje të nxjerra nga komisioni i mbikëqyrjes së sigurimeve dhe autoritete të tjera qeveritare përkatëse;

vii) T'i pajisë aksionarët me njoftime dhe dokumentacion në lidhje me mbledhjet e këshillit mbikëqyrës dhe të aksionarëve 15 ditë përpara datës së mbledhjes;

viii) T'i pajisë aksionarët me një kopje të procesverbaleve të të gjitha mbledhjeve të këshillit mbikëqyrës dhe të aksionarëve brenda 15 ditëve nga data e mbledhjes;

ix) T'i pajisë aksionarët me çdo informacion tjetër që kërkohet prej tyre në mënyrë të arsyeshme, duke përfshirë të drejtën e hyrjes në godinë dhe për të parë regjistrat dhe të dhënat e Shoqërisë;

x) Brenda pesë ditë-pune nga data që e merr Shoqëria, t'i pajisë aksionarët me lajmërim të menjëhershëm me shkrim të ngjarjeve ose kushteve të cilat mund të kenë një ndikim të madh, të pafavorshëm mbi biznesin dhe veprimet e Shoqërisë apo mbi ndonjë ndryshim në ligjin e zbatueshëm që mund të ndikojnë te Shoqëria, biznesi i saj, veprimet ose perspektivat; megjithatë, me kusht që, vetëm për qëllimet e paragrafit 4.01 (o) (x) këtu, një "ditë-pune" do të jetë një ditë në të cilën bankat tregtare dhe tregjet valutore janë të hapura për transaksionin e biznesit në tregun ndërbankar të dollarit në Tiranë, Shqipëri.

Paragrafi 4.02 Zotime negative

Përveç rastit kur aksionarët kanë rënë dakord ndryshe, çdo aksionar do të ushtrojë të drejtat e tij si aksionar që t'i shkaktojë Shoqërisë që dhe Shoqëria:

a) do të deklarojë, anulojë ose paguajë ndonjë dividend apo do të japë ndonjë kontribut tjetër në lidhje me kapitalin e aksioneve të emetuara dhe të autorizuar;

b) do të lidhë ndonjë marrëveshje apo do të bjerë në ujdë (përveç kontratave të sigurimit të lidhura në rrjedhën e zakonshme të biznesit), sipas së cilës ajo mban një përgjegjësi të rastit në cilësinë e garantuesit, ose, në ndonjë farë mënyre apo nga ndonjë kusht, mban përgjegjësi për të gjitha ose një pjesë të ndonjë detyrimi financiar ose të ndonjë detyrimi tjetër të një personi tjetër;

c) do të krijojë, regjistrojë apo lejojë ekzistencën e ndonjë pengu mbi ndonjë prej pasurive të saj, burimeve të të ardhurave apo aseteve të tjera, ekzistuese dhe të ardhshme;

d) do të hyjë në ndonjë marrëveshje për përqindje interesi apo këmbim valutë, marrëveshje për kufi norme interesi, marrëveshje me përqindje të avancuar ose tjetër përqindje interesi, apo marrëveshje që pengon këmbimin e monedhave ose mallrave, apo ndonjë transaksion i prejardhur i ngjashëm, përveç atyre që mund të lejohen në përputhje me direktivat për menaxhimin e aseteve/detyrimeve të parashikuara në deklaratën për rregullat e funksionimit;

e) do të bëjë ndonjë transaksion me çdo person, përveç atyre që kryhen në rrjedhën normale të biznesit, sipas afateve tregtare të zakonshme dhe mbi bazat e ujdive në distancë, bërjes së ndonjë transaksioni ku Shoqëria do të paguajë më shumë se çmimi i pranueshëm brenda direktivave të zbatueshme për të sipas ligjit të zbatueshëm, për çdo blerje ose do të marrë më pak se çmimi i plotë tregtar për produktet ose shërbimet e saj, ose të kryejë ndonjë transaksion që përfshin shitjen e çdo një prej aseteve të saj që kanë një vlerë më të madhe se 5% e vlerës neto të aseteve të Shoqërisë;

f) do të kryejë ndonjë transaksion me Qeverinë e Shqipërisë, investitorin strategjik, filialet ose agjentët, nëpunësit, drejtorët ose pronarët e subjekteve të sipërpërmendura ose ndonjë anëtar të familjeve të tyre, përveç atyre transaksioneve që kryhen në rrjedhën normale të biznesit ose atyre që miratohen specifikisht nga vota unanime e këshillit mbikëqyrës.

g) do të lidhë ndonjë marrëveshje ortakërie, ndarje fitimi apo ndonjë *royalty* ose ndonjë marrëveshje tjetër të ngjashme, ku të ardhurat ose fitimet e Shoqërisë ndahen ose mund të ndahen me ndonjë person tjetër, përveç pagesës që Shoqëria u bën agjentëve të sigurimit si komision sigurimi;

h) do të lidhë ndonjë kontratë menaxhimi ose ndonjë marrëveshje të ngjashme, ku çdo person, përveç ndonjë personi të miratuar nga këshilli mbikëqyrës, drejton biznesin ose veprimet e saj;

i) do të veprojë qëllimisht ose do të mos veprojë, në mënyrë të tillë që mund ta shndërrojë gjendjen financiare të Shoqërisë në më pak të favorshme se në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, ose që mund të rezultojë në zvogëlimin e vlerës së aksioneve të IFI;

j) do të ndërmarrë ndonjë veprim që në njëfarë mënyre bie në kundërshtim me deklaratën për rregullat e funksionimit, duke përfshirë, pa u kufizuar, përputhjen me direktivat financiare dhe raportet financiare të parashikuara aty, me direktivat e mjedisit, politikën kundër pastrimit të parave

dhe me çdo dokument projekti;

k) do të bëjë ndonjë ndryshim të natyrës së biznesit dhe veprimeve të saj ose ndërmarrjen e ndonjë veprimtarie biznesi, përveç shërbimit të sigurimit ose shërbimeve financiare në lidhje me to, ose në mënyrë të drejtëpërdrejtë, ose nëpërmjet ndonjë filiali;

l) do të ndryshojë emrin e saj;

m) do të bëjë ose lejojë ndonjë ndryshim në kapitalin aksionar të autorizuar ose emetuar, duke përfshirë, pa u kufizuar, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të saj, riemërtimin e aksioneve të saj, kryerjen e ndonjë ndarjeje aksionesh apo lëshimin e aksioneve në formë bonusi;

n) do të bëjë apo lejojë bërjen e ndonjë ndryshimi në statut ose në deklaratën për rregullat e funksionimit, përveç rastit kur ndryshimi është në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;

o) do të krijojë apo do të ketë ndonjë filial ose merr pjesë me aksione në kapital të ndonjë person ose ndërmarrje tjetër, përveç shoqërisë INSIG Kosovë dhe INSIG Maqedoni;

p) do të marrë përsipër apo do të lejojë shkrirje, konsolidim ose riorganizim, përveçse në përputhje me këtë Marrëveshje, ose do të marrë përsipër apo të lejojë shitjen ose dhënien me qira të të gjitha ose shumicës së aseteve të saj;

q) do të lidhë kontrata qiraje.

Neni 5

Këshilli mbikëqyrës

Paragrafi 5.01 Përbërja

Këshilli mbikëqyrës do të përbëhet nga gjashtë (6) anëtarë.

Paragrafi 5.02 Zgjedhja e anëtarëve dhe krijimi i komiteteve

Çdo aksionar, gjatë gjithë kohës, do t'i japë votat e tij ose shkakton që të emëruarit e tij të japin votat e tyre, në mënyrë që të kryhet:

a) zgjedhja në këshillin mbikëqyrës e një personi të emëruar nga secili prej EBRD dhe IFC; së paku një prej të cilëve të ketë përvojë të mirë pune në fushën e sigurimeve;

b) zgjedhja në këshillin mbikëqyrës e tre personave të emëruar nga MIF;

c) zgjedhja në këshillin mbikëqyrës e një personi në përputhje me paragrafin 5.03;

d) zgjedhja e njërit prej anëtarëve të emëruar nga MIF si kryetar i këshillit mbikëqyrës; kjo zgjedhje duhet të bëhet me votë unanime;

e) zgjedhja e një komiteti auditimi, i cili përfshin një anëtar të emëruar nga MIF;

f) zgjedhja e një komiteti shpërblimi, i cili përfshin anëtarin e emëruar nga MIF;

g) zgjedhja e një komiteti investimi, i cili do të kryesohet nga një anëtar i emëruar nga EBRD ose IFC dhe do të përfshijë një anëtar të emëruar nga MIF;

h) zgjedhja e një menaxheri të përgjithshëm të Shoqërisë dhe e një shefi llogaritar të Shoqërisë; në të dy rastet kërkohet paraprakisht miratimi me shkrim i aksionarëve të IFI për individët që do të caktohen.

Paragrafi 5.03 Anëtari i gjashtë

a) Anëtari i referuar në paragrafin 5.02(c) do të caktohet nga marrëveshja e përbashkët e të gjithë aksionarëve. Nëse aksionarët nuk arrijnë të bien dakord për identitetin e këtij anëtari brenda dhjetë (10) ditë-pune pas dhënies së njoftimit nga një aksionar aksionarëve të tjerë, ku i bëhet thirrje atyre për të rënë dakord, çështja do t'i referohet për zgjidhje një personi për të cilin është rënë dakord nga aksionarët ose, në mungesë marrëveshjeje, brenda dhjetë (10) ditësh-pune pas dhënies së njoftimit nga një aksionar aksionarëve të tjerë, të cilëve i bën thirrje për të rënë dakord për të zgjedhur një person, bazuar në kërkesën e një aksionari, nga komiteti i zgjedhur në përputhje me paragrafin 5.03(b). Ky person do të veprojë si ekspert dhe jo si arbitër dhe do t'i kërkohet nga aksionarët që të japë vendimin e tij brenda (28) ditësh pas caktimit. Vendimi i tij është i formës së prerë, përfundimtar dhe detyrues për aksionarët. Kostot e këtij eksperti do të paguhën siç mund të vendosë ai ose, në mungesë vendosjeje prej tij, këto kosto do të paguhën në mënyrë të barabartë nga aksionarët.

b) Komiteti i referuar në paragrafin 5.03(a) do të përbëhet nga dy anëtarë, njëri i caktuar nga aksionarët e IFI së bashku dhe një i caktuar nga MIF, në çdo rast brenda dhjetë (10) ditësh-pune pas dhënies së lajmërimit nga një aksionar aksionarëve të tjerë, të cilëve i bën thirrje për të caktuar anëtarët; anëtari i tretë do të caktohet nga anëtarët e caktuar nga aksionarët e IFI dhe të MIF.

Paragrafi 5.04 Procedura e emërimit

a) Aksionarët do të njoftojnë njëri-tjetrin me shkrim mbi personat që ata kanë emëruar si anëtarë, së bashku me të dhënat e arsyeshme të përvojës dhe arsimit të tyre, të paktën dhjetë (10) ditë-pune përpara datës së thirrjes së parë në mbledhjen e përgjithshme relevante duhet t'i dërgohen aksionarëve në përputhje me statutin ose ligjin e zbatueshëm. Kjo kërkesë për emërim mund të hiqet ose periudha e lajmërimit të zvogëlohet, me marrëveshje ndërmjet aksionarëve herë pas here, edhe në mbledhjen e përgjithshme në fjalë.

b) Në mbledhjen e përgjithshme çdo aksionar është i detyruar të japë të gjitha votat e tij në favor të zgjedhjes së kandidatëve të propozuar nga vetë ai dhe të kandidatëve të propozuar nga aksionarët e tjerë.

c) Çdo aksionar mund të propozojë, për ndonjë arsye, heqjen e ndonjë anëtari që është emëruar nga ky aksionar. Emrat e anëtarëve të propozuar për t'u larguar duhet të njoftohen me shkrim nga aksionari që propozon heqjen tek aksionarët e tjerë. Aksionarët janë të detyruar ta mbështesin këtë heqje duke votuar në mënyrën e duhur në mbledhjen e përgjithshme. Procedura për emërimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të parashikuar në paragrafin 5.04(a) dhe (b) do të zbatohet në lidhje me heqjen e një anëtari dhe me emërimin dhe zgjedhjen e një anëtari të ri për të zëvendësuar anëtarin e hequr. Asnjë aksionar nuk mund të votojë për heqjen e ndonjë anëtari, përveç rastit kur është propozuar nga aksionari që e kishte emëruar këtë anëtar për t'u zgjedhur si anëtar.

d) Aksionarët janë të detyruar të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të siguruar që zgjedhja e anëtarëve të rinj të kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur pasi lirohet ndonjë vend, por në çdo rast brenda afatit të parashikuar nga ligji i zbatueshëm.

Paragrafi 5.05 Dëmshpërblimi i anëtarëve

Në varësi të dispozitave dhe të hapësirës që lejon statuti, çdo aksionar do të japë votat e tij, si edhe çdo anëtar i emëruar i Shoqërisë do të japë votat e tij në çdo mbledhje të këshillit mbikëqyrës, në mënyrë që Shoqëria të dëmshpërblejë çdo anëtar prej asetëve të saj përkundrejt çdo detyrimi të tij/saj të shkaktuar gjatë përmbushjes dhe kryerjes aktuale ose të synuar të detyrave të tij/saj, ose gjatë ushtrimit ose ushtrimit të synuar të kompetencave të tij/saj, ose në lidhje me detyrat e tij/saj, kompetencat ose postet, por:

a) ky dëmshpërblim nuk zbatohet për ato detyrime deri në masën që ato zhdëmtohen nga ndonjë person tjetër;

b) ky dëmshpërblim varet nga hapat e arsyeshme që ndërmerr anëtari për të bërë zhdëmtimin, kështu që dëmshpërblimi nuk do të zbatohet për atë pjesë të detyrimit ku mund të zbatohet një e drejtë alternative;

c) në lidhje me shpenzimet e anëtarëve, kur kryejnë detyrat e tyre si anëtarë, këto shpenzime janë në varësi të politikës së rënë dakord nga këshilli mbikëqyrës në çdo kohë.

Neni 6

Marrëveshjet e aksionarëve

Paragrafi 6.01 Ruajtja e aksioneve/ndryshimi i të drejtave

a) Pa paragjykuar dispozitat e Marrëveshjes për blerje aksionesh dhe Marrëveshjes së rishitjes dhe në bazë të ligjit të zbatueshëm, MIF, pa marrë paraprakisht miratimin me shkrim të aksionarëve të IFI, nuk do të shesë, transferojë, atribujë, lërë peng ose barrësojë të gjitha ose një pjesë të aksioneve të MIF tek asnjë person, përveç investitorit strategjik të miratuar me shkrim nga aksionarët e IFI, aprovim i cili nuk do të refuzohet, sepse aksionarët e IFI nuk janë në gjendje të negociojnë kushtet e pranueshme me investitorin strategjik të mundshëm për t'i shitur atij aksionet e IFI.

b) Pa paragjykuar dispozitat e Marrëveshjes për blerjen e aksioneve dhe të Marrëveshjes së rishitjes dhe në bazë të ligjit të zbatueshëm, asnjë aksionar, pa miratimin paraprak me shkrim të aksionarëve të tjerë, nuk do të ndërmarrë ose nuk do të lejojë të ndërmerret asnjë veprim, sipas të cilit të ndryshojnë aksionet ose të drejtat e lidhura me të gjitha aksionet ose me një pjesë të tyre.

Paragrafi 6.02 Kushtet për miratim/transferimi

Eshtë kusht i çdo miratimi ose aprovimi të dhënë sipas paragrafit 6.01 (a) që:

a) MIF t'i japë aksionarëve IFI detaje të kushteve të shitjes së propozuar, kalimit ose transferimit, duke përfshirë shpërblimin e ofruar, identitetin e marrësit të propozuar dhe ndonjë detaj tjetër që kërkohet nga aksionarët e IFI që i njoftohet me shkrim MIF në çdo kohë;

b) MIF të informojë aksionarët e IFI për çdo ngjarje, për të cilën është në dijeni, e cila do ta bënte çdo përfaqësim dhe garanci në dokumentin e projektit të pasaktë ose e cila do të shkaktonte një rast rishitjeje.

Paragrafi 6.03 Të drejtat e transferimit të EBRD dhe IFC

a) Asnjë prej aksionarëve të IFI nuk gëzon të drejtën që, në çdo kohë gjatë periudhës që përfundon në ditën e fundit të muajit të njëzet e katërt pas datës së transferimit ose datës në të cilën faza II e projektit ka përfunduar (cilado datë që është më shpejt), të shesë, transferojë ose kalojë të gjitha aksionet ose një pjesë të tyre te ndonjë palë e tretë, pa marrë paraprakisht miratimin me shkrim të aksionarëve të tjerë.

b) Është kusht që për çdo miratim të dhënë sipas paragrafit 6.03(a) për shitje, transferim ose kalim:

i) aksionari IFI transferues t'i japë secilit prej aksionarëve të tjerë të dhëna të plota mbi kushtet e kësaj shitjeje të propozuar, transferimi ose kalimi duke përfshirë shpërblimin e ofruar, identitetin e personit marrës të propozuar dhe detaje të tjera që kërkohen nga ndonjë aksionar tjetër me shkrim në çdo kohë;

ii) aksionari transferues i IFI të informojë aksionarët e tjerë mbi çdo rast, për të cilin është në dijeni, që mund ta bëjë të pasaktë çdo përfaqësim ose garanci në dokumentin e projektit ose i cili mund të shkaktojë një rast rishitjeje.

c) Aksionet mund të transferohen në çdo kohë prej secilit aksionar të IFI tek tjetri.

Paragrafi 6.04 Të drejtat *tag-along*

Nëse ndonjë aksionar (shitës i propozuar) propozon ose synon t'i shesë ose transferojë aksionet një personi joaksionar, përveç rastit të një shitjeje të propozuar ose synuar të aksioneve të MIF, një investitori strategjik (transferim i propozuar), shitësi i propozuar duhet t'i dërgojë aksionarëve të tjerë njoftim me shkrim (njoftim *tag-along*), i cili specifikon, me të dhëna të arsyeshme, kushtet dhe afatet thelbësore të transferimit të propozuar, duke përfshirë çmimin dhe afatet e pagesës dhe identitetin e blerësit të propozuar. Çdo aksionar që nuk është shitësi i propozuar gëzon të drejtën (që ushtrohet duke i dhënë njoftim me shkrim shitësit të propozuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë-pune pas datës së dhënies së njoftimit *tag-along*) të kërkojë që një nga kushtet në transferimin e propozuar të jetë që blerësi i propozuar t'i blejë të gjitha (por jo më pak se të gjitha) aksionet e atij aksionari (i) me çmimin për aksion që blerësi i propozuar ka propozuar për t'i paguar shitësit të propozuar dhe (ii) në çdo rast, me të njëjtat kushte dhe afate si transferimi i propozuar.

Paragrafi 6.05 E drejta *drag-along*

Në qoftë se MIF i dërgon njoftim në çdo kohë aksionarëve të IFI, ku i kërkon atyre që t'ia shesin të gjitha (por jo më pak se të gjitha) aksionet e IFI investitorit strategjik të propozuar, çdo aksionar i IFI do t'ia shesë aksionet e tij investitorit strategjik të propozuar (i) me çmimin *drag-along* dhe (ii) në çdo rast, me të njëjtat kushte dhe afate që zbatohen për transferimin e aksioneve të MIF tek investitori strategjik i propozuar.

Paragrafi 6.06 E drejta e përparësisë

a) Nëse një aksionar i IFI dëshiron të transferojë aksionet, atëherë ai duhet të njoftojë me shkrim paraprakisht MIF për këtë. Nëse MIF dëshiron, sipas ligjit mbi privatizimin, të transferojë aksionet e tij (përveç transferimit të jo më pak se 51% të kapitalit të Shoqërisë investitorit strategjik), atëherë ai duhet të njoftojë me shkrim paraprakisht aksionarët e IFI për këtë. Në këtë paragraf 6.06 "Transferues" nënkupton aksionarin e IFI ose MIF, që dëshiron të transferojë

aksionet e tij; “Marrës” nënkupton marrësin e njoftimit me shkrim (dhe, në rastin e aksionarëve IFI, “Marrësi” i referohet atyre së bashku) dhe “Njoftim transferimi” nënkupton njoftimin me shkrim.

b) Njoftimi i transferimit duhet të përmbajë, të paktën, informacionin e mëposhtëm:

i) numrin e aksioneve që do të transferohen (Aksionet e transferimit);

ii) çmimin për çdo aksion të transferimit (Çmimi i transferimit);

iii) kushtet e pagesës;

iv) çdo kusht tjetër të transferimit.

c) Njoftimi i transferimit përbëhet nga një ofertë e transferuesit drejtuar marrësit për t'i transferuar këtij të fundit aksionet e transferimit me çmimin e transferimit dhe me kushtet e paraqitura në njoftimin e transferimit, me përjashtim të vetëm që asnjë marrësi nuk do t'i kërkojë për të përmbushur ndonjë kusht jomonetar, të cilin marrësi, në mënyrë të arsyeshme, nuk është në gjendje ta përmbushë (Oferta).

d) Marrësi ka të drejtë t'i blejë të gjitha, por jo më pak se të gjitha, aksionet e transferimit në përputhje me kushtet e ofertës.

e) Marrësi, brenda një periudhe prej gjashtëdhjetë (60) ditësh duke filluar nga data e marrjes së njoftimit të transferimit, i dërgon një njoftim transferuesit, ku deklaron nëse dëshiron të ushtrojë të drejtën e përparësisë për t'i marrë aksionet e transferimit sipas kushteve të ofertës (Njoftimi i pranimit).

f) Nëse njoftimi i pranimit nuk jepet brenda periudhës 60-ditore të përmendur në paragrafin 6.06(e), oferta konsiderohet e refuzuar.

g) Nëse marrësi e pranon ofertën, të gjitha aksionet e transferimit në fjalë i shiten marrësit sipas kushteve të ofertës. Nënshkrimi nga transferuesi dhe nga marrësi i të gjitha dokumenteve të nevojshme për t'u nënshkruar nga ato, me qëllim transferimin e aksioneve të transferimit, do të zhvillohet në orën dhe vendin që është rënë dakord me shkrim nga transferuesi dhe marrësi, por në mungesë të kësaj Marrëveshje do të kryhet në selinë e Shoqërisë, në orën 14.00 me orën e Tiranës, në ditën e njëzet (20) të punës pas datës së marrjes së njoftimit të pranimit nga transferuesi. Në rast se marrësi e refuzon ofertën ose nëse oferta konsiderohet e refuzuar në përputhje me paragrafin 6.06(f), transferuesi ka të drejtën t'ia transferojë të gjitha, por jo më pak se të gjitha, aksionet e transferimit një pale të tretë, brenda një periudhe prej njëqind e njëzet (120) ditësh duke filluar nga: (i) dita e fundit e periudhës gjashtëdhjetëditore të përmendur në paragrafin 6.06 (f); ose (ii) data në të cilën transferuesi merr njoftimin nga marrësi që ai e refuzon ofertën, cilado ditë qoftë relevante. Transferimi tek pala e tretë nuk mund të bëhet për një çmim që është më i ulët se çmimi i transferimit, gjithashtu transferimi nuk mund të kryhet me afate dhe kushte më të favorshme për personin që do t'i bëhet transferimi sesa ato që përmbahen në ofertë.

h) Çdo ofertë do të shqyrtohet sipas radhës së marrjes së njoftimeve të transferimit nga marrësi i duhur. Menjëherë pasi procesi i shqyrtimit të një oferte ka filluar sipas procedurës së sipërpërmendur, shqyrtimi i ofertave të tjera të mëpasme nuk do të fillojë derisa shqyrtimi i ofertës së përparme të ketë përfunduar.

i) Nëse transferimi tek marrësi ose tek pala e tretë, që përmendet në paragrafin 6.06(g), i nënshtrohet një vendimi të një enti shtetëror, periudhat prej njëzet (20) ditësh-pune dhe njëqind e njëzet (120) ditësh të referuara në paragrafin 6.06 (g), në rast se vendimi nuk është marrë deri në ditën e dhjetë (10) të punës përpara përfundimit të periudhës së duhur, do të zgjaten në mënyrë që periudha në fjalë të përfundojë në fund të ditës së dhjetë (10) të punës pas ditës në të cilën subjekti shtetëror përkatës merr vendimin e detyrueshëm.

Paragrafi 6.07 Transferimi

a) Nëse aksionet do të transferohen, do të shiten ose do të kalohen në përputhje me paragrafët 6.01, 6.03, 6.04 ose 6.05 te një person që nuk është palë e kësaj Marrëveshjeje, transferuesi (në rastet e paragrafëve 6.01 dhe 6.03) ose shitësi i propozuar (në rastin e paragrafit 6.04) ose MIF (në rastin e paragrafit 6.05) është i detyruar të sigurojë që një nga kushtet e transferimit të jetë që të drejtat dhe detyrimet e transferuesit sipas kësaj Marrëveshjeje t'i kalohen dhe t'i transferohen personit që i është bërë transferimi, së bashku me aksionet përkatëse.

b) Nëse aksionet e transferimit që do të transferohen sipas paragrafit 6.06 përfaqësojnë të gjitha aksionet e zotëruara nga transferuesi dhe nëse i transferohen një personi që nuk është palë në

marrëveshje, transferuesi është i detyruar të sigurojë si kusht transferimi që çdo e drejtë dhe detyrim i transferuesit sipas kësaj Marrëveshjeje t'i caktohen dhe t'i kalohen marrësit së bashku me transfertën e aksioneve të transferimit.

c) Nëse aksionet e transferimit që do të transferohen sipas paragrafit 6.06 nuk përfaqësojnë të gjitha aksionet e zotëruara nga transferuesi dhe nëse i transferohen një personi që nuk është palë në marrëveshje, do të jetë kusht i transferimit që marrësi dhe palët e kësaj Marrëveshjeje të lidhin një marrëveshje aksionarësh me kushte të ngjashme me këtë, dhe palët e kësaj Marrëveshjeje do bëjnë përpjekje të arsyeshme për të vepruar në këtë mënyrë.

Paragrafi 6.08 Parimet

Do të zbatohet sa më poshtë:

a) Ushtrimi i rishitjes (siç përkufizohet në Marrëveshjen e rishitjes) nga një aksionar i IFI nuk do t'i nënshtrohet dispozitave të paragrafëve 6.03(a), 6.04 ose 6.06.

b) Transferimi i aksioneve, që rrjedh nga ushtrimi i të drejtave të MIF sipas paragrafit 6.05, nuk do t'i nënshtrohet dispozitave të paragrafëve 6.03(a), 6.04 ose 6.06.

c) Transferimi i aksioneve nga MIF aksionarit IFI sipas paragrafit 6.06 nuk do t'i nënshtrohet dispozitave të paragrafit 6.01(a). Transferimi i aksioneve nga MIF tek aksionari IFI sipas paragrafit 6.06 nuk do t'i nënshtrohet dispozitave të paragrafit 6.01(a).

d) Transferimi i aksioneve që rrjedh nga ushtrimi i të drejtave të një aksionari sipas paragrafit 6.04 nuk do t'i nënshtrohet dispozitave të paragrafëve 6.01(a), 6.03(a) ose 6.06.

e) Transferimi i aksioneve që rrjedh nga ushtrimi i të drejtave të një aksionari të IFI sipas paragrafit 6.03(c) nuk do t'i nënshtrohet dispozitave të paragrafëve 6.03(a), 6.04(a) ose 6.06.

f) Çdo njoftim do të shqyrtohet në përputhje me radhën e marrjes. Menjëherë pas fillimit të procesit të shqyrtimit të njoftimit, shqyrtimi i njoftimeve të tjera të mëpasme nuk do të fillojë derisa të ketë përfunduar shqyrtimi i njoftimit të mëparshëm.

g) Në rast se aksionet shiten nga MIF nëpërmjet një oferte publike të aksioneve, dispozitat e paragrafëve 6.01(a), 6.04 dhe 6.06 nuk do të aplikohen për këtë ofertë, me kusht që çdo aksionar i IFI të ketë të drejtë të përfshijë çdo ose të gjitha aksionet e tij në këtë ofertë publike me të njëjtin çmim dhe me të njëjtat kushte të zbatuara për aksionet e MIF.

Paragrafi 6.09 Marrëveshje e posaçme

Çdo aksionar:

a) duhet të sigurojë që çdo konflikt interesash ekzistues ose i mundshëm midis tij dhe Shoqërisë të sillet në vëmendje të Shoqërisë dhe të aksionarëve të tjerë me mundësinë më të parë dhe këto konflikte duhet të zgjidhen në përputhje me këtë Marrëveshje dhe këtë statut;

b) as personalisht e as nëpërmjet një agjenti:

(i) nuk do të përdorë, zbulojë ose të bëjë të njohur te ndonjë palë e tretë asnjë informacion sekret apo të ndonjë natyre të fshehtë që ka lidhje me biznesin ose çështje të Shoqërisë, përveç kur kërkohej me ligj ose rregullore, ose deri në masën që ky informacion është i përhapur në publik jo nëpërmjet shkeljes së paragrafit 6.09(b)(i), me kusht që çdo aksionar mund ta përdorë, zbulojë ose ta bëjë të njohur këtë informacion te punonjësit e tij ose aksionarët, siç mund të nevojitet në rrjedhën e zakonshme të biznesit pas marrjes së masve paraprake për të ruajtur natyrën konfidenciale të këtij informacioni; ose

(ii) nuk do të përdorë ose (për sa kohë që e bën në mënyrë të arsyeshme) nuk do të lejojë të përdoret (përveçse nga Shoqëria) asnjë emër tregtar që përdoret nga Shoqëria ose ndonjë emër tjetër që mendohet ose ka të ngjarë të ngatërrohet me këtë emër tregtar;

c) nuk do të lërë peng, hipotekë ose krijojë ndonjë lloj pengese apo barrë mbi ose në lidhje me aksionet e zotëruara nga ai, përveçse në përputhje me dokumentet e projektit; dhe

d) nuk do të nënshkruajë asnjë marrëveshje (përveç kësaj Marrëveshjeje) që ka të bëjë me të drejtat e votimit ose ndonjë të drejtë tjetër lidhur me aksionet e zotëruara prej tij.

Paragrafi 6.10 Reforma në sektorin e sigurimeve

MIF do të bëjë përpjekjet e tij më të mira në mbështetje të miratimit të reformave ligjore dhe rregullatore nga Republika e Shqipërisë deri më 30 qershor 2004, të pranueshme për aksionarët e IFI për të lejuar shoqëritë e sigurimit, përfshirë Shoqërinë, që të funksionojnë në një mënyrë tregtare pa pengesa thelbësore nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë; me kusht që asgjë në këtë

paragraf 6.10 nuk do të pengojë rregullimin dhe mbikëqyrjen e Shoqërisë nga ligji i zbatueshëm dhe ushtrimin e funksioneve, kompetencave, detyrave nga komisioni i mbikëqyrjes së sigurimeve.

Neni 7 Deklarata dhe garanci

Paragrafi 7.01 Deklarata dhe garanci të MIF

Me anë të këtij dokumenti, MIF deklaron dhe i garanton çdo aksionari IFI që nga data e kësaj Marrëveshjeje se:

a) ka kompetencat dhe autoritetin për të nënshkruar këtë Marrëveshje me miratim të kësaj Marrëveshjeje nga Parlamenti dhe me publikimin e ligjit përkatës që aprovon këtë Marrëveshje në Fletoren Zyrtare, Ministri i Financës ka kompetencën (në emër të MIF) dhe autoritetin për të zbatuar këtë Marrëveshje;

b) me miratim të kësaj Marrëveshjeje nga Parlamenti dhe me publikimin e ligjit përkatës që aprovon këtë Marrëveshje në Fletoren Zyrtare dhe me zbatim të palës tjetër dhe dorëzimit të saj, kjo Marrëveshje do ketë autorizimin e duhur dhe do të dorëzohet nga MIF dhe do përbëjë detyrime ligjërish të vlefshme dhe të kushtëzuara për MIF, të zbatueshme në përputhje me kushtet e saj. Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje dhe përputhshmëria me termat e saj:

i) nuk do të jetë në kundërshtim me asnjë nga dispozitat që përmban çdo ligj i zbatueshëm për Ministrinë e Financave apo nga Shteti shqiptar;

ii) nuk do të vijë në kundërshtim apo të shkelë ndonjë nga dispozitat, apo të kërkojë ndonjë miratim, apo të vendosë ndonjë barrë në bazë të ndonjë marrëveshjeje apo instrumenti, ku MIF ose Qeveria shqiptare është palë apo me të cilat lidhen MIF ose Qeveria shqiptare ose pronat e saj; dhe

iii) nuk do të përbëjë një mospërmbushje apo rast i cili, me dhënien e njoftimit, me kalimin e kohës apo me marrjen e ndonjë vendimi, apo ndonjë kombinimi të tyre, do të përbënte mospërputhje në një marrëveshje apo instrument të kësaj natyre; dhe

d) për nënshkrimin, zbatimin apo dorëzimin në kohë nga MIF, ose vërtetësinë apo zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje nuk kërkohet asnjë autorizim; dhe

e) nuk do të vendoset asnjë tarifë ose taksë tjetër apo ndonjë detyrim i ndonjë subjekti shtetëror ose i asnjë organi tatimor, federate apo shoqërie, në të cilën bën pjesë Republika e Shqipërisë, për shkak të nënshkrimit, dorëzimit apo zbatimit të kësaj Marrëveshjeje ose çdo transaksioni të parashikuar në lidhje me këtë, që të sigurojë ligjshmërinë, vërtetësinë, zbatueshmërinë ose pranueshmërinë si provë të kësaj Marrëveshjeje në Republikën e Shqipërisë.

Paragrafi 7.02 Deklarime dhe garanci të secilit prej aksionarëve IFI

Secili prej aksionarëve IFI me anë të këtij dokumenti deklarojnë dhe i garantojnë Ministrisë së Financave, si dhe aksionarëve të tjerë IFI, që nga data e kësaj Marrëveshjeje, se:

a) ai ka kompetencat dhe autoritetin për të nënshkruar dhe zbatuar këtë Marrëveshje;

b) ka autorizim (nëse ka) për nënshkrimin, dorëzimin ose zbatimin e rregullt të kësaj Marrëveshjeje; dhe

c) kjo Marrëveshje përbën detyrime të vlefshme ligjore të këtyre aksionarëve IFI dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje dhe përputhja me kushtet e saj:

i) nuk do të vijë në kundërshtim me ndonjë dispozitë të ligjeve të zbatueshme për aksionarët IFI ose ndonjë konventë ndërkombëtare të zbatueshme për aksionarin IFI;

ii) nuk do të vijë në kundërshtim ose nuk do të shkelë asnjë dispozitë, kërkojë ndonjë miratim, apo të vijë në kundërshtim apo të vendosë ndonjë barrë, në bazë të ndonjë marrëveshjeje apo instrumenti në të cilën bëjnë pjesë këta aksionarë IFI; ose

iii) nuk do të përbëjë mospërmbushje apo rast i cili, me dhënien e njoftimit, me kalimin e kohës apo me marrjen e ndonjë vendimi, apo ndonjë kombinimi të tyre, do të përbënte një mospërmbushje në një marrëveshje ose instrument të kësaj natyre.

Neni 8 Të ndryshme

Paragrafi 8.01 Tërësia e Marrëveshjes, ndryshime dhe dorëheqje

Kjo Marrëveshje dhe dokumentet e referuara në të përbëjnë detyrimin tërësor të aksionarëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje dhe do të zëvendësojë çdo shprehje të mëparshme qëllimi dhe mirëkuptimi në lidhje me këtë transaksion. Çdo ndryshim apo dorëheqje nga ndonjë nga afatet ose kushtet e kësaj Marrëveshjeje (përfshirë këtu, pa u kufizuar, këtë paragraf) do të bëhet me shkrim.

Paragrafi 8.02 Njoftimet

Çdo njoftim, kërkesë apo komunikim tjetër që do të jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje për çdo palë do të jetë me shkrim. Përveç rasteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, një njoftim i tillë, kërkesë apo komunikim tjetër do të konsiderohet se është dhënë ose bërë në kohë, kur jepet dorazi, me postë, faks, në adresën e palës së përcaktuar më poshtë ose në atë adresë tjetër që njëra palë i njofton palës tjetër që bën njoftimin, kërkesën ose komunikimin.

Për EBRD:

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
One Exchange Square
London EC2A 2JN
United Kingdom

Për IFC:

International Finance Corporation
2121 Pennsylvania Avenue, NW
Washington Dc
20433 USA

Në vëmendje të Njesisë së Administrimit të
Veprimit

Fax: 44 20 7338 6100

Në vëmendje të Drejtorit, Departamenti i
Tregjeve Financiare Botërore

Fax: 202 974 4872

Një kopje për Drejtorin, Departamenti i Europës
Jugore dhe i Azisë Qendrore

Fax: 202 974 4849

Për MIF:

Ministria e Financës së Republikës të Shqipërisë
Bul.Dëshmorët e Kombit
Tiranë
Republika e Shqipërisë

Për Shoqërinë:

INSIG
Rruga e Dibrës
Tiranë
Republika e Shqipërisë

Në vëmendje të Ministrit të Financës

Fax: 355 42 284 94

Në vëmendje të Drejtorit të Përgjithshëm

Fax: 355 42 238 38

Paragrafi 8.03 Gjuha angleze

Të gjitha dokumentet që do të dorëzohen apo njoftimet që do të bëhen sipas kësaj Marrëveshjeje do të jenë në gjuhën angleze.

Paragrafi 8.04 Përlllogaritje financiare

Me përjashtim të rasteve kur ndryshe është rënë dakord, të gjitha përlllogaritjet financiare do të kryhen në përputhje me IAS sipas ose për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

Paragrafi 8.05 Të drejta, mjete ligjore dhe dorëheqje

a) Nuk do të jenë objekt i një hetimi të drejtat dhe mjetet ligjore të çdo aksionari kur keqdeklarohet ose shkelet garancia nga ose në emër të këtij aksionari mbi çështjet e ndonjë aksionari tjetër apo Shoqërisë, ose kur nënshkruhet ose përmbushet kjo Marrëveshjeje apo çdo akt apo veprim tjetër nga ose në emër të Shoqërisë apo këtij aksionari në lidhje me këtë Marrëveshjeje dhe e cila, përveç këtij paragrafi, mund të paragjykojë këto të drejta dhe mjete ligjore.

b) Nuk do të dëmtojë të drejtën, kompetencën ose mjetet ligjore të këtij aksionari asnjë linjë për marrëveshje apo dorëheqje nga ai përsa i përket dispozitave të kësaj Marrëveshjeje në lidhje me dispozita të tjera ose të interpretohet si dorëheqje nga këto dispozita.

c) Nuk do të dëmtojë asnjë të drejtë, kompetencë ose mjet ligjor dhe nuk do të kuptohet si dorëheqje ose pranim në heshtje e saj asnjë linjë për marrëveshje dhe asnjë vonesë ose mungesë në ushtrimin e të drejtave, kompetencave ose mjeteve ligjore që i shtohet aksionarit për mospërmbushje të kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë marrëveshjeje tjetër. Asnjë ushtrim i plotë ose i pjesshëm i këtyre të drejtave nuk do të pengojë asnjë ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të tyre ose ushtrimin e ndonjë të drejte, kompetence ose mjeti tjetër ligjor. Asnjë veprim i këtij aksionari në lidhje me një mospërmbushje të tillë apo miratim të tij nuk do të ndikojë ose dëmtojë të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të këtij aksionari lidhur me mospërmbushje të tjera.

d) Të drejtat dhe mjetet ligjore të parashikuara në këtë Marrëveshjeje janë plotësuese dhe jo përjashtuese të të drejtave dhe mjeteve ligjore të tjera si ato të parashikuara nga një ligj i zbatueshëm, ashtu edhe ndonjë mënyrë tjetër.

e) Aksionarët bien dakord që nëse një dispozitë e statutit në çdo kohë nuk pajtohet me çdo dispozitë të kësaj Marrëveshjeje, aksionarët do të ushtrojnë të gjitha kompetencat dhe të drejtat e mundshme si aksionarë ose ndryshe, brenda kohëzgjatjes së nevojshme, të lejojnë Shoqërinë të rregullojë veprimtarinë e saj sikurse e parashikuar në Marrëveshjeje.

Paragrafi 8.06 Ligji i zbatueshëm

Kjo Marrëveshje do të rregullohet në përputhje me ligjet e Anglisë dhe të Uellsit.

Paragrafi 8.07 Arbitrazhi dhe juridiksioni

a) Çdo mosmarrëveshje, kundërshti apo pretendim që ngrihet në lidhje me këtë Marrëveshje, ose shkelje, zgjidhje ose pavlefshmëri e saj, do të zgjidhet nga arbitrazhi në përputhje me rregullat UNCITRAL të arbitrazhit në fuqi. Arbitrazhi do të kryhet nga një arbitër i vetëm dhe ai emërohet nga Gjykata e Londrës për Arbitrazhin ndërkombëtar. Vendi i arbitrazhit do të jetë Londra dhe në të gjitha procedurat e arbitrazhit do të përdoret gjuha angleze. Aksionarët IFI heqin dorë nga çdo e drejtë që i njej ligji i arbitrazhit i vitit 1996 ose, në një mënyrë tjetër, kërkojnë një vendim arbitrazhi ose vendim paraprak të ligjit nga gjykatat e Anglisë. Gjykata e arbitrazhit nuk autorizohet të marrë ose japë, dhe MIF pranon se nuk do të kërkojë nga asnjë organ gjyqësor marrjen e ndonjë mase provizore mbrojtëse ose vendim paraprak lehtësues kundër EBRD-së dhe IFC-ve, pavarësisht nga dispozitat e Rregullave të Arbitrazhit të UNCITRAL. Gjykata e arbitrazhit ka kompetencë të çmojë dhe përfshijë në gjykim, vendim ose urdhër çdo mosmarrëveshjeje të mëtejshme që do të paraqitet rregullisht përpara tij nga çdo aksionar (por jo palë tjetër) për sa kohë që mosmarrëveshjet lindin nga dokumentet e projektit, por, përveç sa më sipër, asnjë mosmarrëveshje tjetër nuk do të përfshihet ose shkrihet me procedurën e arbitrazhit.

b) Pavarësisht nga paragrafi 8.07(a), kjo Marrëveshje dhe dokumentet e projektit, si dhe e drejtë e aksionarëve IFI, që buron nga apo lidhet me këtë Marrëveshje ose çdo dokument projekti, nëse aksionarët dëshirojnë, mund të ekzekutohet nga aksionarët në gjykatat e Republikës së Shqipërisë apo çdo gjykatë tjetër që ka juridiksion. MIF në favor të aksionarëve IFI, në mënyrë të përvokueshme, i nënshtrohet juridiksionit joekskluziv të gjykatave të Anglisë dhe Republikës së Shqipërisë në lidhje me çdo mosmarrëveshje, kundërshti ose pretendim që lind ose ka lidhje me këtë Marrëveshje apo çdo dokument tjetër të projektit, ose shkeljen, zgjidhjen ose pavlefshmërinë e saj. MIF dhe IFC-të caktojnë, emërojnë dhe autorizojnë personin e përcaktuar në paragrafin 8.13 për të vepruar si agjent i autorizuar për të marrë njoftimin e thirrjes në gjykatë dhe çdo thirrje tjetër ligjore në Angli për qëllimet e çdo procedure ligjore të nisur nga aksionarët në lidhje me këtë Marrëveshje. Çdo IFC ose MIF, në mënyrë të pakthyeshme, jep pëlqimin për marrjen e njoftimeve të procedurave të arbitrazhit ose të çdo thirrjeje ligjore duke postuar kopje të saj me rekomande të parapaguar tek adresa e saj ose përsa i përket IFC-ve tek adresa e agjentit të saj. Çdo IFC dhe MIF pranon se, për sa kohë që ka detyrime sipas kësaj Marrëveshjeje, do të mbajë brenda afatit një agjent të autorizuar për të marrë njoftimin e thirrjes në arbitrazh apo çdo thirrje tjetër në Angli për qëllim të çdo veprimi ligjor apo procedure në lidhje me këtë Marrëveshje dhe do t'i njoftojë palët për identitetin dhe vendndodhjen e këtij agjenti. Asgjë e përmendur këtu nuk do të cenojë të drejtën e aksionarëve IFI për të nisur një proces ose procedurë ligjore kundër MIF-së me çdo mënyrë të parashikuar nga ligjet

e çdo juridiksioni përkatës. Nisja e procedurave ligjore nga aksionarët IFI në një ose më shumë juridiksione nuk do të përjashtojë fillimin nga aksionarët të procedurave ligjore në çdo juridiksion tjetër nëse kryhen në të njëjtën kohë apo jo. MIF, në mënyrë të pakthyeshme, heq dorë nga çdo kundërshtim që mund të ketë tani ose më vonë për vendin e zhvillimit të procedurave ligjore dhe çdo pretendim që mund të ketë tani ose më vonë se procedura ligjore përkatëse është zhvilluar në një forum të papërshtatshëm.

Paragrafi 8.08 Privilegje dhe imunitete të EBRD-së dhe IFC-së

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të interpretohet si dorëheqje, mohim ose ndryshim i çdo imuniteti apo privilegji të EBRD-së të dhëna në përputhje me Marrëveshjen për Themelimin e Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, konventave ndërkombëtare ose çdo ligj tjetër të zbatueshëm dhe për IFC-të të përcaktuara sipas neneve të Marrëveshjes, konventës ndërkombëtare ose çdo ligji tjetër të zbatueshëm.

Paragrafi 8.09 Pasardhësit dhe të caktuarit

Kjo Marrëveshje do të detyrohet dhe imponohet në interes të pasardhësve dhe të caktuarve të autorizuar nga palët, me përjashtim të rastit kur asnjë palë nuk do të dorëzojë ose ndryshe transferojë të gjitha ose ndonjë pjesë të të drejtave dhe detyrimeve të saj të parashtruara në Marrëveshje pa miratimin paraprak me shkrim të çdo pale tjetër. Palët do të japin më parë miratimin me shkrim për çdo kalim ose transferim të kontratës, sikurse e kërkuar nga kushtet e paragrafit 6.07.

Paragrafi 8.10 Dhënia e informacionit

Çdo aksionar mund të bëjë publike ato dokumente, informacione dhe të dhëna rreth këtij transaksioni (përfshirë pa u kufizuar kopje të çdo dokumenti) që vlerësohen si të përshtatshme në lidhje me çdo mosmarrëveshje që përfshin cilëndo palë të dokumentit të projektit, me qëllim ruajtjen apo zbatimin e të drejtave të saj të parashtruara në çdo dokument të projektit.

Paragrafi 8.11 Kopje të Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të hartohet në disa kopje, secila prej të cilave do të konsiderohet si origjinale, por të gjitha së bashku do të përbëjnë një marrëveshje të vetme.

Paragrafi 8.12 Veçimi

Dispozitat e përfshira në çdo paragraf të kësaj Marrëveshjeje do të jenë të zbatueshme pavarësisht nga secila prej të tjerave dhe vlefshmëria e saj nuk do të ndikohet nëse ndonjëra prej tyre është e pavlefshme. Nëse ndonjëra nga këto dispozita është e pavlefshme, por do të bëhet e vlefshme nëse pjesë të këtyre dispozitave do të fshiheshin, atëherë dispozitat në fjalë do të përdoren me ndryshimet e bëra, të cilat konsiderohen të nevojshme për ta quajtur atë të vlefshme.

Paragrafi 8.13 Agjentët e njoftimit

Për MIF dhe Shoqërinë:

The Embassy of the Republic of Albania
2 Floor
24 Buckingham Gate
London SW1 E 6LB
England

Për IFC:

International Finance Corporation
4 Millbank
London SW1P 3JA
England

Paragrafi 8.14 Të drejtat e palëve të treta

Kjo Marrëveshje nuk i jep asnjë lloj të drejte një personi të tretë që nuk është palë dhe gjithashtu ligji i kontratave (Të drejtat e palëve të treta) 1999 nuk zbatohet në këtë Marrëveshje.

Në dëshmi të sa më sipër, palët këtu, duke vepruar me anë të përfaqësuesve të tyre të autorizuar, bëjnë që kjo Marrëveshje të nënshkruhet nën emrat e tyre në datën e shënuar në fillim të kësaj Marrëveshjeje.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

Së shpejti në botim, përmbledhje në fushën e taksave dhe tatimeve

Doli nga shtypi më 5.3.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë